



MANUALI I

LICENCIMIT TË SIGURUESVE

PRISHTINË, TETOR 2017

Preambula

Në përputhje me nenin 36, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 i Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, si dhe nenin 16 të Statutit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës si dhe në zbatim të Ligjit nr. 05/L-045 për Sigurimet Bordi Ekzekutiv, në mbledhjen e mbajtur më 27 tetor 2017 miratoi:

MANUALI I LICENCIMIT TË SIGURUESVE

PËRMBAJTJA

1.	HYRJE.....	5
1.1.	Përkufizimet.....	7
2.	PROCESI I APLIKIMIT PËR LICENCIM TË SIGURUESVE	8
2.1.	Faza e para-aplikimit.....	8
2.2.	Faza e aplikimit.....	9
2.2.1.	Plani i biznesit	11
2.2.2.	Kapitali.....	13
2.2.3.	Struktura udhëheqëse.....	15
2.2.4.	Letra mbështetëse.....	18
2.2.5.	Dorëzimi i aplikacionit.....	18
2.3.	Faza e pas-aplikimit.....	19
2.3.1.	Shqyrtimi i aplikacionit	20
2.4.	Miratimi paraprak.....	20
3.	LICENCIMI.....	22
3.1.	Aplikimi për licencë	23
3.2.	Ekzaminimi i parahapjes	24
3.3.	Dhënia e Licencës	24
4.	MIRATIMET E TRANSAKSIONEVE TJERA.....	25
4.1.	Ndryshimi i emrit	26
4.2.	Ndryshimet në aktin e themelimit dhe/apo statutin.....	26
4.3.	Ndryshimi në kapital.....	27
4.4.	Aksionarët kryesor	27
4.5.	Emërimi i drejtorëve dhe menaxherëve të lartë.....	28
4.6.	Zgjerimi i veprimtarisë.....	30
4.7.	Hapja dhe zhvendosja e degëve dhe zyrave brenda vendit.....	31
4.8.	Mbyllja e degëve dhe zyrave brenda vendit.....	32
4.9.	Hapja e degëve ose e subjekteve të varura jashtë vendit	32
4.10.	Auditori i jashtëm.....	33
4.11.	Transferimi i portofolit të sigurimit.....	34
4.12.	Delegimi i funksioneve.....	36

4.13.	Bashkimet dhe përvetësimet.....	38
4.14.	Përvetësimet e interesit të kapitalit nga siguruesit në institucionet financiare.....	40
4.15.	Hapja e zyrave përfaqësuese	41
4.16.	Transaksionet që kërkojnë vetëm njoftim të BQK-së	42
5.	SHTOJCAT E MANUALIT	42

1. HYRJE

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka përgjegjësi ekskluzive për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së sigurimeve në Republikën e Kosovës sipas nenit 23 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (më tutje Ligji për BQK-në) dhe nenit 4 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-045 për Sigurimet (më tutje Ligji për Sigurimet).

Korniza ligjore në fuqi, ndër tjerash e përcakton BQK-në si kompetente për:

- licencimin e siguresve/risiguresve;
- revokimin e licencave siguresve/risiguresve;
- menaxhimin ose mbikëqyrjen e procedurës së rehabilitimit (administrimit zyrtar) dhe fillimin e procedurave të falimentimit;
- vlerësimin e kushteve dhe dhënien e miratimit/refuzimit për transaksionet e përcaktuara në kapitullin katër (4) të këtij manuali.

Të interesuarit për të themeluar një sigures duhet fillimisht të aplikojnë për licencë për zhvillim të veprimtarisë sigures nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK). Siguresit e jashtëm me seli kryesore jashtë Republikës së Kosovës, të interesuar për licencë sigures, mund të licencohen nga ana e BQK-së për të zhvilluar veprimtari sigures si subjekte të varura (filial) apo si degë, për detaje referojuni shtojcës IV - Siguresit e Jashtëm¹.

Të interesuarit për licencë të siguresit, mund të licencohen nga ana e BQK-së për të zhvilluar:

- veprimtari të sigurimit të jo-jetës, për klasë të veçanta të sigurimit, në përputhje me nenin 7 të Ligjit për Sigurime;
- veprimtari të sigurimit të jetës, veçmas ose për të gjitha klasat e sigurimit e përcaktuara me nenin 8 të Ligjit për Sigurime;
- veprimtari të risigurimit, për të gjitha klasat e veprimtarisë së sigurimit.

Në kontekst të licencimit të siguresve objektivi i përgjithshëm i BQK-së është që të sigurojë një proces transparent gjithëpërfshirës, i cili ndihmon për të siguruar një mjedis të sigurt, të qëndrueshëm dhe konkurrues në industrinë e sigurimeve. Në funksion të përmbushjes së këtij objektivi, përmes rritjes së transparencës dhe inkurajimit të efikasitetit dhe konkurrencës, BQK ka rishikuar politikën, procedurat dhe praktikën e licencimit të siguresve në mënyrë që të sigurojë një kornizë dinamike, efektive, dhe të strukturuar. Pjesë e këtij procesi ka qenë edhe miratimi i Manualit të Licencimit të Siguresve.

Manuali i licencimit të siguresve përcakton kushtet dhe procedurat e nevojshme që duhen përmbushur nga subjektet aplikuese për marrjen e licencës së siguresve, me qëllim të hyrjes në treg të subjekteve sigures të shëndosha dhe të qëndrueshme, që mbështeten nga aksionarë të fuqishëm dhe me përvojë në industrinë e sigurimeve. Siguresit e tillë realizojnë veprimtari të ekuilibruar me rreziqe të menaxhuara, janë në gjendje të përballojnë dhe të zhvillohen në kushtet e konkurrencës së lirë që ofron një treg i hapur dhe i integruar në tregun financiar ndërkombëtar si dhe janë në gjendje të përballojnë me kapital dhe

¹ Të gjitha kriteret e licencimit të siguresve vlejnë njëjtë për subjektet e varura filial apo degë përveç nëse është specifikuar ndryshe.

likuiditet situatat e krizave. Në këtë mënyrë arrijnë të mbështesin zhvillimin e ekonomisë së vendit dhe në mënyrë transparente i ofrojnë publikut shërbime dhe produkte cilësore dhe efikase të sigurimeve.

Manuali ofron udhëzime të veçanta për pranimin dhe vlerësimin e aplikacioneve dhe përcakton dokumentet minimale të nevojshme për aplikim për licencim të sigurueseve. Duhet të theksohet se manuali është vetëm një udhëzues procedural dhe nuk përfshin të gjithë faktorët, që mund të vlerësohen gjatë fazës së analizës. Gjatë procesit të aplikimit informacione shtesë mund të kërkohen nga ana e BQK-së varësisht nga kompleksiteti i situatës. Megjithatë, manuali shërben si një udhëzues për të gjithë të interesuarit potencial për themelimin e sigurueseve dhe degëve të siguruesve të jashtëm dhe njëkohësisht lehtëson trajtimin e aplikacioneve për licencim nga stafi i Departamentit për Licencim dhe Standardizim në kuadër të BQK-së nga i cili do të shfrytëzohet si manual referues, udhëzues pune dhe si mjet trajnues.

Struktura vijuese e manualit është si më poshtë.

Kapitulli i dytë (2) i manualit shtjellon pjesën thelbësore të procesit të aplikimit duke filluar nga faza e para-aplikimit, faza e aplikimit dhe faza e pas-aplikimit. Faza e para-aplikimit kalon nëpër çështjet bazike, duke përfshirë vendimin nëse themelimi i një siguruesi është gjëja e duhur për të interesuarit dhe çfarë mund të jenë alternativat. Të interesuarit që të themelojnë një sigurues mund të gjejnë këtë pjesë të dobishme sepse këtu përfshihen detajet e takimeve para aplikimit ku ndahen pritjet e BQK-së, që mundëson kuptimin se çfarë do të thotë kjo për aplikuesit dhe burimet e tyre si dhe gjërat të cilat vlerësohen të dobishme për të dyja palët: të interesuarit dhe BQK-në.

Në fazën e aplikimit, sqarohet se çfarë ndodh pasi që të vendoset përfundimisht të aplikohet për t'u bërë një sigurues i ri. Kjo pjesë fillon me listimin e dokumentacionit minimal të nevojshëm për aplikim dhe vazhdon me diskutimin e strukturuar përreth komponentëve kryesor të aplikacionit për licencim të siguruesve për nga pesha a tyre në vendimmarrjen e BQK-së. Si përmbyllje e kësaj pjesë në këtë kapitull është sqarimi i dorëzimit formal të aplikacionit në BQK.

Faza e pas-aplikimit përcakton se çka vlerëson BQK në aplikacionin për licencim të siguruesve, sqaron arsyet për vendim pozitiv dhe ato për vendim negativ si dhe kohën që i duhet për të marr një vendim. Faza e pas-aplikimit përfundon me fazën opsionale në këtë proces, të quajtur miratimi paraprak i licencës i cili merret pas shqyrtimit dhe vlerësimit të të gjithë dokumenteve dhe informacioneve të pranuar si aplikacion në këtë proces.

Kapitulli i tretë (3) mbulon fazën përfundimtare të licencimit të një siguruesi e cila zhvillohet pas miratimit paraprak. Kjo fazë fillon me aplikimin e siguruesit të propozuar për licencim pas përmbushjes së obligimeve të përcaktuara me vendimin për miratim paraprak. Gjatë kësaj faze, BQK realizon edhe ekzaminimin e parahapjes në objektet e siguruesit të propozuar për verifikimin e kushteve për fillimin e veprimtarisë siguruese. Faza përfundimtare mbyllet me dhënien e licencës apo refuzimin saj.

Transaksionet tjera të cilat realizohen pas licencimit të siguruesit dhe fillimit të operacioneve të saj e që për të cilat kërkohet miratim paraprak nga ana e BQK-së, janë sqaruar në kapitullin katër (4) të këtij manuali. Në këtë kapitull është përcaktuar gjithashtu edhe dokumentacioni i kërkuar për miratimin e këtyre transaksioneve, afatet si dhe procedura e shqyrtimit. Gjithashtu në këtë kapitull është përfshirë edhe licencimi i klasave shtesë të sigurimit për siguruesit të cilët kanë marrë licencë për të ushtruar veprimtari në klasa të caktuara të sigurimit por kërkojnë të ushtrojnë veprimtari në klasa të tjera të sigurimit.

Manuali përmbillet me kapitullin e pestë (5) i cili përmban shtojca të cilat japin sqarime të detajizuara për çështje të caktuara duke mbështetur përmbajtjen e manualit dhe formularët e nevojshëm për aplikim, për licencim të siguruesve dhe miratim të transaksionve tjera.

Për ndonjë sqarim shtesë apo për ndonjë pyetje individuale, të interesuarve ju rekomandohet të kontrollojnë pjesën “Pyetjet më të shpeshta” në uebfaqen e BQK-së si dhe shtojcat I – Procesi i Licencimit, II – Kriteret e Licencimit, III- Alternativat ndaj Licencimit të Siguruesve dhe IV- Siguruesit e Jashtëm, të këtij manuali apo të kontaktojnë direkt Departamentin për Licencim dhe Standardizim në BQK përmes emailit Licencimi@bqk-kos.org ose përmes telefonit në numrin +381 (0) 38 222 055.

Vëmendje: Manuali aplikohet përshtatshëmrisht edhe për licencimin e risiguruesve.

1.1. Përkufizimet

Të gjitha shprehjet e përdorura në këtë manual kanë të njëjtin kuptim siç përcaktohen me nenin 3 të Ligjit për Sigurimet dhe/ose siç janë përkufizuar në vijim për qëllim të këtij manuali:

Sigurim - nënkupton transferimin e një rreziku të mundshëm, të një humbjeje pasurore dhe/ose jopasurore nga i siguruari te siguruesi, sipas një kontrate sigurimi;

Veprimtari e sigurimit - nënkupton përgatitjen, ofrimin, nënshkrimin dhe zbatimin e kontratave të sigurimit të jetës dhe jo-jetës nga siguruesit;

Risigurim - nënkupton sigurimin që një sigurues blen nga një ose më shumë sigurues tjerë (risigurues) direkt ose nëpërmjet një ndërmjetësuesi. Risigurimi konsiderohet si një mjet i menaxhimit të rrezikut pasi që cedon rreziqet e caktuara nga një sigurues te një risigurues;

Risiguruesi - mund të jetë një sigurues i specializuar për risigurim, i licencuar nga BQK-ja, i cili merr përsipër vetëm biznesin e risigurimit;

Veprimtari e risigurimit - nënkupton nënshkrimin dhe zbatimin e kontratave të risigurimit, për kalimin e një pjese apo gjithë rrezikut të marrë përsipër, nëpërmjet kontratës së sigurimit, nga siguruesi në një risigurues;

Klasë e sigurimit - nënkupton klasifikimin e një grupi të ngjashëm të produkteve dhe rreziqeve ose operacioneve, që përcaktojnë veprimtarinë e siguruesit sipas licencës së lëshuar nga BQK-ja;

Produkt i sigurimit - nënkupton kontratën (policën) specifike të përgatitur dhe të lëshuar nga siguruesi, për të mbuluar një rrezik specifik ose një numër të veçantë të rreziqeve sipas kushteve të përcaktuara;

Subjekt i varur - nënkupton personin juridik të veçantë i themeluar nga siguruesi ose personi juridik, që është nën kontroll të përbashkët me siguruesin;

Degë e Siguruesit të jashtëm - nënkupton degën e siguruesit të jashtëm, e cila ka selinë kryesore në ndonjë vend të jashtëm dhe është licencuar për të ushtruar veprimtari siguruese në Republikën e Kosovës;

Aksionar kryesor - nënkupton posedimin direkt apo indirekt në një subjekt, i cili përfaqëson dhjetë përqind (10%) ose më shumë të aksioneve, me të drejtë vote;

Drejtor - nënkupton çdo person, i emëruar nga aksionarët për të shërbyer si anëtar i bordit të drejtorëve të siguruesit;

Drejtor joekzekutiv - nënkupton drejtorët, të cilët nuk janë punonjës të siguruesit apo ndërmjetësuesit dhe nuk janë të përfshirë në menaxhimin operacional të tyre;

Menaxher i lartë - nënkupton kryeshefin ekzekutiv, zëvendës kryeshefin ekzekutiv (nëse është e aplikueshme) zyrtarin kryesor për financa, zyrtarin kryesor për marrje në sigurim, zyrtarin kryesor për dëme dhe çdo person tjetër që (i) i raporton drejtpërsëdrejti bordit të drejtorëve ose merr pjesë ose ka autoritet për të marrë pjesë në funksionet kryesore politikëbërëse të siguruesit apo subjekteve tjera të licencuara sipas këtij ligji; (ii) është caktuar si menaxher i lartë nga BQK-ja. Në rastin e degës së siguruesit të jashtëm të licencuar në Kosovë, menaxherë të lartë konsiderohen: menaxheri kryesor, zëvendës menaxheri kryesor (nëse është e aplikueshme), zyrtari kryesor për financa, zyrtari kryesor për marrje në sigurim, zyrtari kryesor për dëme si dhe çdo person tjetër që BQK-ja e përcakton si menaxher të lartë.

Aktuar - nënkupton personin, i cili ka për detyrë kryesore llogaritjen e tarifave të primeve, provizioneve teknike dhe matematike, duke u mbështetur në metodat aktuaristike;

Delegim - nënkupton transferimin, e një ose disa funksioneve të veprimtarisë së siguruesit te një person tjetër, funksione të cilat në rast të mos-delegimit kryhen nga vetë siguruesi;

Portofol i sigurimit - nënkupton tërësinë e kontratave të sigurimit të një klase ose disa klasave të sigurimit, të nënshkruara nga një sigurues;

Degë - do të thotë një vend i biznesit, përkatësisht një pjesë ligjërisht e varur e një siguruesi, që kryen drejtpërdrejtë të gjitha punët ose një pjesë të punëve të siguruesit;

Zyrë – do të thotë një vend i veprimtarisë afariste e pa themeluar me vete, që i përgjigjet degës së siguruesit nëpërmjet të cilës siguruesi mund të lejohet që të angazhohet në veprimtari të sigurimeve.

2. PROCESI I APLIKIMIT PËR LICENCIM TË SIGURUESVE

Ky kapitull fillon me zbërthimin e fazës së para-aplikimit si fazë fillestare e procesit të licencimit të siguruesve ku diskutohen elemente bazike si vendimi mbi themelimin e një siguruesi si dhe sqarohet takimi informues para aplikimit, si pjesa më e rëndësishme e kësaj faze. Kapitulli pastaj vazhdon me shtjellimin e fazës së aplikimit e cila fillon me marrjen e vendimit përfundimtar për të aplikuar për licencim si sigurues. Kjo pjesë përfshin informacion në lidhje me atë se çka duhet të përmbaj aplikacioni për licencim si sigurues. Faza e aplikimit pasohet nga ajo e pas-aplikimit ku sqarohet se çka vlerëson BQK dhe sa kohë mund t'i duhen për të dhënë një vendim. Kjo fazë përfundon me sqarimin e fazës optionale në këtë proces, të quajtur miratimi paraprak.

2.1. Faza e para-aplikimit

Të interesuarit për licencim si sigurues, në varësi të planit të biznesit ose veprimtarive që dëshirojnë të ndërmarrin, fillimisht duhet të vlerësojnë nëse themelimi i një siguruesi është i vetmi opsion apo opsioni më i përshtatshëm për ta. Të interesuarve i'u sugjerohet referimi informatave më të hollësishme në kapitujt e radhës së këtij manuali për të parë nëse themelimi i një siguruesi mund të jetë alternativa më e përshtatshme për vizionin e tyre. Nëse, kanë konstatuar se themelimi i një siguruesi është rruga e duhur dhe janë të gatshëm për të filluar procesin, duhet të kontaktojnë BQK-në për të kërkuar organizimin e takimit informues para aplikimit. Kërkesa për takim dërgohet nga përfaqësuesi i autorizuar i aplikuesit në e-mailin kontaktues të Departamentit për Licencim dhe Standardizim: Licencimi@bqk-kos.org. BQK-ja

pranon aplikacionet për licencim të siguruesve vetëm nëse paraprakisht është mbajtur takimi informues.

Takimi Informues

Para zhvillimit të takimit informues, të interesuarit duhet ta shqyrtojnë plotësisht këtë manual, në mënyrë që të njohohen me të gjitha procedurat që kanë të bëjnë me licencimin e siguruesve.

Takimi informues është i obligueshëm për licencim të siguruesve sepse mundëson:

- kuptimin e procesit të licencimit dhe çfarë ndodh në faza të ndryshme;
- kuptimin e pritjeve të BQK-së;
- identifikimin e ndonjë shqetësimi të veçantë që BQK mund të ketë në fillim, që mund të ndihmoj në vendimin nëse të interesuarit duan të shpenzojnë kohë dhe para në një aplikacion që nuk mund të përparojë më tej;
- dorëzimin sa më të plotë të aplikacionit.

Para mbajtjes së takimit informues të interesuarit për aplikim duhet të përgatiten për të prezantuar në takim një përmbledhje të shkurtër të propozimit të biznesit, që si minimum duhet të përmbajë:

- arsyeshmërinë e themelimit të siguruesit si dhe strategjinë fillestare të biznesit duke specifikuar se cilat produkte do të ofrohen, si do t'i ofrohen ato dhe tregun e synuar;
- burimet e financimit - si do të financohen dhe nëse kanë ndonjë investitor dhe/ose fonde në vend;
- pronësinë dhe ekipin menaxherial - detajet e pronarëve dhe menaxherëve të propozuar, për aq sa ato njihen;
- planin kohor- një pasqyrë dhe afat kohor të planit për të themeluar siguruesin e ri.

Takimi informues udhëhiqet nga Guvernatori apo Zëvendësguvernatori për Mbikëqyrje Financiare (ZGMF), apo ndonjë i deleguar i tij Drejtori i Departamentit për Licencim dhe Standardizim si dhe një zyrtar i lartë përgjegjës për veprimtaritë e licencimit. Rrjedhimisht në takim duhet që të marrin pjesë të gjithë aksionarët kryesor të siguruesit të ri të propozuar. Gjatë takimit, të interesuarit për aplikim inkurajohen që të shtojnë pyetje rreth procesit të licencimit dhe paqartësive të mundshme që kanë në mënyrë që të sigurohet përgatitja e aplikacionit në mënyrë sa më efektive. Departamenti për Licencim dhe Standardizim gjithherë duhet të mbajë procesverbalin e takimeve informuese si dëshmi të këtij procesi në dosjen e aplikuesit.

Takimi informues ju jep një mundësi të interesuarve për aplikim për të diskutuar planet me BQK-në dhe i jep mundësi BQK-së për t'i kuptuar ato plane. Rrjedhimisht, në fund të takimit pritët që të interesuarit të kenë më të qartë procesin e licencimit të siguruesve dhe se aplikacioni kur të dorëzohet, të jetë me cilësi të mjaftueshme për BQK-në që të marrë një vendim sa më shpejt që të jetë e mundur. Ritmi në të cilin të interesuarit për aplikim përparojnë përmes fazës së para-aplikimit varet në masë të madhe nga vet ata dhe përgatitjet e tyre.

2.2. Faza e aplikimit

Pas mbajtjes së takimit informues, aplikuesit mund të fillojnë përgatitjen e aplikacionit për licencim të siguruesve në BQK. Kjo pjesë fillon me listimin e dokumenteve mbështetëse që duhet të jenë pjesë e

aplikacionit për licencim të siguruesve. Pjesa tjetër është e strukturuar rreth komponentëve kryesor të aplikacionit për licencim të siguruesve për nga pesha a tyre në vendimmarrjen e BQK-së, të cilat janë plani i biznesit, struktura udhëheqëse, financimi, dhe letra e mbështetjes në rastet kur aplikohet për themelimin e një dege apo subjekti të varur të një siguruesi të jashtëm. Si përmbyllje e kësaj faze është sqarimi i dorëzimit formal të aplikacionit në BQK.

Aplikacioni për licencim të siguruesve duhet të shoqërohet nga informacionet e mëposhtme siç është përcaktuar me nenin 10 të Ligjit për Sigurimet dhe Rregulloren për Licencimin e Siguruesve dhe Degëve të Siguruesve të Jashtëm:

- dokumentet përbërëse të siguruesit të propozuar, duke përfshirë një kopje të noterizuar apo dokumentacionin origjinal sipas të cilit është themeluar, si dhe adresën e propozuar të zyrës qendrore;
- emrin, nacionalitetin, vendbanimin, kualifikimet dhe përvojën e drejtorëve dhe menaxherëve të lartë të siguruesit të propozuar, duke përfshirë historikun afarist dhe profesional për dhjetë (10) vitet e fundit;
- dokumentin që vërteton posedimin e kapitalit të autorizuar dhe të zotuar të siguruesit të propozuar ose degës së siguruesit të jashtëm si dhe fondit shtesë për shpenzimet fillestare sipas përcaktimeve të nenit 19 paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit për Sigurimet dhe Rregullores për Licencimin e Siguruesve dhe Degëve të Siguruesve të Jashtëm, duke përfshirë të dhënat mbi burimin e kapitalit dhe fondit shtesë;
- listën e aksionarëve, llojin e aksioneve, të dhënat për vlerën nominale të aksioneve, përqindjen e pjesëmarrjes në kapitalin aksionar dhe personat apo palët e mundshme të ndërlidhura;
- planin e biznesit që përfshin, ndër të tjera, strukturën organizative të siguruesit të propozuar ose siguruesit të jashtëm; llojin e parashikuar të veprimtarive siguroese dhe pasqyrat e parashikuara financiare për tri (3) vite;
- të dhënat personale, historikun afarist dhe profesional për dhjetë vitet e fundit dhe pasqyrat financiare të audituara për tri (3) vitet e fundit (nëse ekzistojnë) të çdo aksionari kryesor që mbajnë dhjetë përqind (10%) a më shumë të aksioneve të siguruesit të propozuar;
- për çdo drejtor ose menaxher të lartë apo aksionar kryesor të siguruesit të propozuar ose të degës së siguruesit të jashtëm, dëshminë zyrtare nga Gjykata që shpalos çdo dënim për vepra penale, dosjet personale të falimentimit, diskualifikimi nga ushtrimi i profesionit apo përfshirjen e kaluar ose të tashme në funksion menaxhues të ndonjë korporate ose organi tjetër sipërmarrës (si pasqyra të ATK-së dhe Trustit Penisonal), që i është nënshtruar procedurave të paaftësisë paguese, nëse ka;
- draft-kontratat, duke përfshirë kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës së sigurimit në përputhje me klasën e sigurimit për të cilën ka kërkuar të licencohet;
- plan-programin për zbatimin e masave për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit;
- në çdo rast kur paraqitësi i kërkesës është një sigurues i jashtëm, që propozon themelimin e një kompanie varëse të sigurimeve ose të një dege në Kosovë, duhet të sigurohet një deklaratë nga

autoriteti mbikëqyrës i vendit amë se nuk ka kundërshtim rreth fillimit të veprimtarive të propozuara në Kosovë dhe se ushtron mbikëqyrje të konsoliduar të veprimtarisë ndaj siguruesit të jashtëm përfshirë kompaninë varëse të sigurimeve apo degën e siguruesit të jashtëm, që kërkon të licencohet në Kosovë;

- dëshminë e pagesës së tarifës për licencim;
- dokumentet e kërkuara në formularin për aplikim dhe informacione tjera shtesë të cilat mund të konsiderohen si të duhura nga BQK-ja.

2.2.1. Plani i biznesit

Planit i biznesit është një prej elementeve kyçe në procesin vendimmarrës për dhënien e licencës, pasi që parakusht për themelimin e një siguruesi, që mbështet dhe nuk rrezikon stabilitetin e përgjithshëm financiar në vend është planifikim adekuat strategjik i biznesit.

Plani i biznesit i siguruesit të propozuar duhet fillimisht të përmbajë deklaratën e filozofisë së përgjithshme të siguruesit dhe të përcaktoj vizionin e tij për qëndrueshmërinë financiare dhe ardhmërinë e tij. Gjithashtu, duhet të jetë i konstruktuar në formë të tillë në mënyrë që të zbërthoj qartë zhvillimin strategjik afatgjatë të siguruesit të propozuar në tregun e synuar. Plani duhet të mundësoj vlerësimin e realizimit të strategjisë zhvillimore afatgjatë përmes identifikimit të qartë të planeve afatmesme dhe afatshkurtra të biznesit të mbështetura nga projeksionet financiare. Strategjia afatgjatë e siguruesit të propozuar duhet të përkthehet në qëllime specifike dhe objektiva të matshme afatmesme dhe afatshkurtra, të cilat duhet të arsyetojnë rritjen e parashikuar si dhe të mbështetet me kapitalin e siguruesit të propozuar duke arsyetuar kështu projeksionet financiare.

Plani i biznesit, për të qenë i pranueshëm nga BQK, duhet minimalisht të përmbajë informatat e mëposhtme:

- pasqyrën e biznesit: strategjinë e përgjithshme të siguruesit të propozuar dhe detajet mbi veprimtarinë e planifikuar siguruese;
- analizën e tregut duke përfshirë analizën e konkurrencës direkte dhe indirekte;
- analizën financiare ku përfshihet shpalosja e strukturës së asetëve, detyrimeve dhe kapitalit si dhe projeksionet financiare për tre (3) vitet e para të operimit, si dhe programin e planifikuar për ri-sigurimin;
- funksionet e rëndësishme siguruese;
- strukturën udhëheqëse të siguruesit.

Pasqyra e biznesit

Në pasqyrën e biznesit fillimisht shpaloset historiku i aplikuesit në të cilën ofrohen informata lidhur me organizimin, veprimtarinë të cilën ushtron si dhe shtrirjen gjeografike të degëve të tij për të vazhduar më pastaj me strategjinë e përgjithshme të siguruesit të propozuar e zbërthyer në qëllime afatshkurtra dhe afatmesme të cilat duhet të jenë specifike, të qarta dhe të matshme. Gjithashtu në këtë pjesë pritet edhe argumentimi mbi vlerën e shtuar të siguruesit të propozuar për sistemin financiar në vend.

Në këtë pjesë të planit duhet të bëhet edhe shpalosja e veprimtarisë së planifikuar siguruese, konkretisht detajet e produkteve dhe shërbimeve të cilat planifikohen të ofrohen si dhe objektivat për të ardhmen lidhur me këto produkte dhe shërbime. Planifikimi duhet të përfshijë gjithashtu edhe trendin e rritjes së primeve, rritjes së dëmeve dhe veprimtaritë tjera siguruese.

Analiza e tregut

Në planin e biznesit, siguroesi i propozuar duhet të paraqes analizën e tregut ku duhet të përshkruhet industria e sigurimeve me detaje të mjaftueshme për të mundësuar vlerësimin e identifikimit të sfidave dhe perspektivës me të cilat siguroesi i propozuar do të përballë. Në këtë pjesë duhet të identifikohet qartë dhe të përshkruhet mjaftueshëm tregu i synuar në të cilin pritet të ofrohen veprimtaritë e përshkruara në pjesën paraprake. Gjithashtu, në analizën e tregut siguroesi i propozuar duhet të identifikoj nevojat e tregut për produktet dhe shërbimet e propozuara si dhe argumentoj plotësimin e këtyre nevojave përmes veprimtarisë së sigurimeve që planifikon ta ofroj. Deri në masën nevojshme për marrjen e vendimeve afariste, duhet të përshkruhen edhe trendet e zhvillimit të tregut të synuar.

Komponent i rëndësishëm i analizës së tregut është analiza e konkurrencës. Siguroesi i propozuar në planin e biznesit duhet të identifikoj qartë konkurrencën direkte dhe indirekte brenda tregut të synuar dhe atë që mund të ndikojnë në strategjinë zhvillimore të saj. Në analizën e konkurrencës duhet të paraqitet edhe pozicioni i siguroesit së propozuar përballë konkurrencës së identifikuar.

Analiza e tregut duhet të përmbaj edhe identifikimin e qartë të kërkesave rregullative që aplikohen në tregun e synuar si dhe strategjinë që siguroesi i propozuar do ta ndjekë për të siguruar pajtueshmëri me to. Pjesë përbërëse e analizës së tregut duhet të jetë edhe analiza e konkurrueshmërisë apo SWOT Analiza ku identifikohen përparësitë dhe dobësitë e siguroesit dhe degëve të siguroesve të jashtëm së propozuar kundruall konkurrencës, kërkesave rregullative dhe tregut në përgjithësi.

Analiza e tregut duhet të bazohet në përdorimin e të dhënave aktuale ekonomike në dispozicion, në mënyrë që të gjitha planifikimet të pasqyrojnë apo të jenë sa më të përafërta me realitetin. Burimet e informacionit të përdorura rishqyrtohen për besueshmërinë e tyre dhe janë të rëndësishme në rishikimin e të dhënave.

Struktura organizative

Në planin e biznesit duhet të shpjegohet e gjithë struktura organizative e siguroesit së propozuar me detaje të mjaftueshme të cilat do të mundësojnë vlerësimin e adekuatshmërisë së asaj strukture konform kërkesave ligjore dhe rregullative për zhvillimin e veprimtarisë siguruese. Për të lehtësuar procesin e vlerësimit të BQK-së në këtë pjesë duhet të paraqitet edhe një organogram i cili duhet të përmbajë minimalisht informatat e mëposhtme:

- skemën organizative me emrat individual, sipas nevojës;
- përbërjen e bordit të drejtorëve;
- listën e komiteteve dhe përgjegjësitë kryesore (të sigurohen emrat e anëtarëve, të mundshëm);
- përshkrimin e pozitës së kryeshefit ekzekutiv dhe menaxhereve tjerë të lartë duke përfshirë kufijtë mesatarë të pagave (përfshirja e bonuseve ose pagesave tjera jomonetare p.sh. automobilat, banimi);

- planifikimin e personelit (numri i punëtorëve/departamentet).

Në kuadër të strukturës organizative, siguruesi i propozuar duhet të kujdeset të shpalos planet rreth krjimit të funksioneve kyçe të kërkuara me kornizën ligjore në fuqi, siç janë Asambleja e përgjithshme e aksionarëve, Bordi i drejtorëve; Menaxhmenti i lartë si dhe komitetet e Bordit të Drejtoreve (komiteti i auditimit, komiteti për menaxhim të rrezikut dhe komiteti për menaxhim të investimeve). Informata të mjaftueshme duhet të shpalosen edhe për funksionet tjera të cilat rrjedhin nga korniza ligjore.

Në rastin kur të interesuarit për licencë të siguruesit aplikojnë për marrjen e licencës për te të themeluar një degë të siguruesit të jashtëm, struktura organizative e paraqitur në planin e biznesit nuk kërkohet të përmbajë përbërjen e bordit të drejtorëve dhe listën e komiteteve.

Analiza Financiare

Plani i biznesit të siguruesit të propozuar duhet të përmbaj edhe analizën financiare ku përfshihet shpalosja e strukturës së aseteve, detyrimeve dhe kapitalit si dhe projeksionet financiare për tre (3) vitet e para të operimit.

Në kuadër të strukturës së aseteve dhe detyrimeve siguruesi i propozuar duhet të paraqes përparësitë dhe mangësitë e strukturës së propozuar, duke përfshirë çdo veprim që do të ndërmerret për të zvogëluar rreziqet si dhe teknikat dhe sistemet për menaxhimin e tyre. Për strukturën e kapitalit siguruesi i propozuar në planin e biznesit të tij duhet të sqaroj mënyrën apo bazën e përdorur për të arritur strukturën e kapitalit të propozuar dhe të argumentoj se përse shuma e propozuar është e mjaftueshme për zhvillimin e veprimtarisë së planifikuar siguruese. BQK pret që siguruesi i propozuar të posedojë një shumë të mjaftueshme të kapitalit për të konkurruar në mënyrë efektive në treg dhe të mbështes në mënyrë adekuate operacionet e planifikuara. Duke marrë parasysh që është element kyç në procesin vendimmarrës për dhënien e licencës kjo pjesë elaborohet më tutje në pjesën 2.2.2. në këtë kapitull.

Parashikimet apo projeksionet financiare në planin e biznesit të siguruesit të propozuar duhet të tregojnë trendet e ardhshme të aseteve, detyrimeve dhe kapitalit, aftësisë paguese- solvencës, kalkulimit të riskut sigures, vëllimin për çdo lloj produkti, investimet fikse të mjeteve si dhe shpërblimin e menaxhmentit dhe stafit. Parashikimet duhet të bëhen në bazë të planeve dhe objektivave të planifikuara (të cilat duhet të dorëzohen si pjesë e aplikacionit), analizave të tregut dhe strategjive të diskutuara më lart. Forma e këtyre parashikimeve të kërkuara është e paraqitur në Shtojcën D – Forma e Projeksioneve Financiare, në këtë manual.

2.2.2. Kapitali

Njëri ndër kriteret kyçe i cili merret parasysh për marrjen e vendimit për miratimin apo refuzimin e kërkesës për licencë të siguruesit është kapitali i zotuar që planifikohet të investohet dhe burimi i fondeve të tij. Sipas nenit 19 të Ligjit për Sigurimet dhe nenit 4 të Rregullores për Licencimin e Siguruesve dhe Degëve të Siguruesve të Jashtëm, aplikuesi për licencë si sigurues ose degë e siguruesit të jashtëm për të ushtruar veprimtari të sigurimeve jo jetë duhet të ketë kapital themeltar si fond garantues në vlerë jo më të ulët se dy milion e dyqind mijë (2,200,000) euro.

Në rastin kur një ose disa rreziqe përfshihen në klasat 10 deri në 15 të përcaktuara me nenin 7 të Ligjit për Sigurimet, atëherë kapitali themeltar nuk mund të jetë më i ulët se në vlerën prej tre milion e dyqind mijë (3,200,000) euro.

Aplikuesi për licencë si sigurues ose degë e siguruesit të jashtëm për të ushtruar veprimtari të sigurimeve jetë duhet të ketë kapital themeltar si fond garantues në vlerë jo më të ulët se tre milion e dyqind mijë (3,200,000) euro.

Kapitali themeltar i risiguruesve të licencuar për ushtrimin e veprimtarisë së risigurimeve në Kosovë, nuk mund të jetë më i ulët se tre milion e dyqind mijë (3,200,000) euro.

Siguruesit dhe risiguruesit duhet gjithashtu të kenë edhe një fond shtesë për shpenzime fillestare, për të mbuluar shpenzimet e themelimit, funksionimit dhe administrimit, i cili në çdo rast nuk duhet të jetë më i vogël se njëzet përqind (20%) e kapitalit themeltar.

Sipas, nenit 20 të Ligjit për Sigurimet, kapitali minimal duhet të paguhet në paratë gatshme dhe se fondet e tij nuk mund të rrjedhin nga:

- kreditë nga banka; apo
- kreditë nga publiku;
- si dhe fonde tjera origjina e të cilave është e jashtëligjshme.

Aksionet e lëshuara në këmbim të shërbimeve nuk trajtohen si kapital i paguar.

Pavarësisht kapitalit minimal të referuar më lartë, kapitali i siguruesit të propozuar duhet të jetë i mjaftueshëm për të përmbushur kërkesat rregullative, si dhe të sigurojë një mbrojtje për siguruesin e propozuar sidomos gjatë organizimit fillestar dhe fazave fillestare të operimit. BQK-ja ka të drejtë për të kërkuar rritjen e minimumit të kapitalit për siguruesin e propozuar, bazuar në aplikacionin e tij, konkretisht planin e biznesit dhe projeksionet financiare. Përveç kapitalit të zotuar, siguruesi i propozuar në dokumentacionin e tij duhet të paraqet edhe planet për rritjen e tij brenda tre viteve të para. BQK-ja me rregullore të veçantë, përcakton mënyrën e llogaritjes së ekuitetit, marginës minimale të solvencës dhe treguesve të tjerë të likuiditetit. Siguruesi i propozuar gjithashtu duhet shpjeguar se si planifikon të siguroj pajtueshmëri me Rregulloren e BQK-së për Mjaftueshmërinë e Kapitalit dhe rregulloret tjera që ndikojnë në kapital.

Në strukturën e kapitalit aplikuesi duhet të paraqet edhe numrin e aksioneve të autorizuar, numrin e aksioneve që do të emetohen, vlera nominale për aksion dhe çmimi i shitjes për aksion. Për aksionarët që posedojnë më shumë se pesë përqind (5%) të aksioneve të siguruesit, duhet të sigurohen të dhënat financiare të tyre (referojuni shtojcës B & C në këtë manual). Të dhënat financiare do të përfshijnë bilancin e gjendjes dhe pasqyrën e të ardhurave (fitimin/humbjen) gjatë tre viteve të kaluara. BQK-ja do të vlerësojë aksionarët e propozuar me mbi dhjetë përqind (10%) të aksioneve për të përcaktuar aftësinë aktuale financiare të tyre apo interesave të tyre të ndërlidhura, që do të mund të ndikonin negativisht në siguruesin e propozuar.

Informatat e dhëna në BQK duhet të nënshkruhen nga aksionarët me dëshminë për saktësinë dhe kompletimin e tyre. BQK-ja do të verifikoj burimet dhe do të kërkojë që shuma e kapitalit të paguhet para lëshimit të regjistrimit.

Përshtatshmëria e aksionarëve

Përshtatshmëria e aksionarëve kryesorë potencial është gjithashtu element shumë i rëndësishëm në vlerësimin e BQK-së. Për të verifikuar përshtatshmërinë e aksionarëve, aplikuesi në dokumentacionin e tij

për licencim si sigurues duhet të ofrojë dëshmi që vërteton qëndrueshmërinë financiare për çdo aksionar kryesor potencial. Kjo përfshin dëshmi të përmbushjes së shpejtë të detyrimeve financiare të kaluara dhe një gjendje ekzistuese të shëndoshë financiare. Aplikuesi duhet të dorëzoj dokumentacion valid që vërteton pagesën e të gjitha detyrimeve fiskale nga aksionari kryesor potencial. Dokumenti i tillë duhet të jetë i lëshuar jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga data e aplikimit.

Gjatë shqyrtimit të aplikacionit BQK-ja do të verifikojë në mënyrë të pavarur, personat që kontrollojnë siguruesit ose që janë propozuar të kontrollojnë atë. Ky autorizim përfshin mbledhjen e dëshmive dhe dokumenteve në procedurat formale sipas procedurave administrative përkatëse.

BQK-ja do të vlerësojë, strukturën e pronësisë së një sigurues potencial si tërësi, si dhe përshtatshmërisë individuale të aksionarëve, në mënyrë që të sigurojë se struktura e pronësisë nuk do të pengojë mbikëqyrjen efektive të siguruesit. Kërkesat e cekura më lartë janë kërkesa të vazhdueshme për aksionarët ekzistues dhe aksionarët e ri potencial. Përshtatshmërinë e aksionarëve kryesorë potencial, vlerësohet sipas kërkesave të nenit 10 dhe 24 të Ligjit për Sigurimet. Për këtë qëllim BQK ka të drejtë të mbledhë dëshmi në pajtim me nenit 10, 24 dhe 35 të Ligjit për Sigurimet dhe nenit 6 të Rregullores për Licencimin e Siguruesve dhe Degëve të Siguruesve të Jashtëm.

Kjo kërkesë nuk aplikohet për aplikacionet e Degëve të Siguruesve të Jashtëm, që tentojnë për të themeluar degë në Republikën e Kosovës.

2.2.3. Struktura udhëheqëse

Bordi i drejtoreve dhe menaxhmenti i lartë është shumë i rëndësishëm për suksesin e një siguruesi të ri. Përzgjedhja e një kryeshefi ekzekutiv dhe menaxhmenti tjetër të lartë të kualifikuar dhe profesional, si dhe një bordi të drejtorëve adekuat është një ndër detyrat më me rëndësi të siguruesit të propozuar. Kryeshefi ekzekutiv i propozuar duhet të përfshihet në mënyrë aktive në zhvillimin e aplikacionit për licencë dhe duhet të jetë plotësisht i njoftuar me planin e biznesit të siguruesit të propozuar pasi që ai person duhet të zbatojë me sukses drejtpërdrejtë planin e propozuar të siguruesit.

Përshtatshmëria e drejtorëve dhe menaxherëve të lartë të propozuar konsiderohet si thelbësore në procesin e BQK-së për licencimin dhe mbikëqyrjen e sigurueseve. Si pjesë e procesit të licencimit, nenet 24, 27 dhe 32 të Ligjit për Sigurimet, Rregullorja për Licencimin e Siguruesve dhe Degëve të Siguruesve të Jashtëm kanë përcaktuar kriterin “i përshtatshëm dhe i duhur” dhe kriterin e pavarësisë për miratimin e drejtorëve dhe menaxherëve të lartë. Elementet të cilat merren në konsideratë për këto kritere përfshijnë: të dhënat mbi veprat penale, pozitën financiare, veprimet civile kundër individëve për ndjekjen e borxhit personal, refuzimi i anëtarësimit apo përjashtimi nga organizatat profesionale, sanksione të zbatuara nga rregullatorët e industrive të ngjashme dhe praktikata e mëhershme të dyshimta të biznesit. Çdo aksionar kryesor, drejtor, menaxher i lartë si dhe aktuari i siguruesit duhet të përmbushin kërkesat për i përshtatshëm dhe i duhur, në lidhje me pozicionin përkatës

BQK-ja mund kryej hetime lidhur me historikun e personave të propozuar si menaxher të lartë, drejtor dhe aksionar kryesor të siguruesit së propozuar si dhe menaxher të degëve apo zyrave përfaqësuese. Këto hetime mund të kryhen për të verifikuar nëse personat e propozuar i plotësojnë kriteret e parapara me legjislacionin në fuqi për të qenë në ato pozita. BQK-ja mund të ndaj me rregullatorët e institucioneve të tjera financiare çfarëdo informacioni që e pranon si rezultat i hetimeve të saja.

Sa i përket të kaluarës penale të aksionareve kryesor, drejtorëve (anëtarëve të bordit të drejtorëve), menaxherëve të lartë dhe personave tjerë për të cilët kërkohet inspektim, sipas Udhëzimit Nr. 01/2015 për verifikimin e të kaluarës penale për aksionarët kryesor, drejtorët dhe menaxherët e lartë të institucioneve financiare, BQK-ja sipas vlerësimit të saj, mund të kërkoj informacione edhe nga organet kompetente sipas legjislacionit në fuqi, sa i përket personave të propozuar për miratim.

Një person nuk konsiderohet i përshtatshëm për të qenë kryesues, drejtor dhe menaxher i lartë nëse i njëjti:

- është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepër penale, me gjashtë (6) muaj apo më shumë burg;
- është larguar nga posti i një siguruesi me kërkesë të BQK-së;
- me vendim të organeve kompetente i është hequr ose pezulluar e drejta e ushtrimit të profesionit;
- ka qenë drejtor ose menaxher i lartë i një siguruesi, licenca e të cilit është revokuar apo paaftësia e pagesës ose likuidimi i detyruar i atij siguruesi është iniciuar gjatë mandatit të tij.

Zyrtarët e lartë publik, mund të shërbejnë si drejtor të ndonjë siguruesi, duke iu nënshtruar kufizimeve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit, në ushtrimin e funksionit publik.

Siguruesi, sapo të vihet në dijeni të rrethanave të cilat tregojnë se ndonjë drejtor ose menaxher i lartë mund të mos jetë person i përshtatshëm dhe i duhur, duhet ta njoftojë menjëherë BQK-në.

Aplikuesit për licencë të siguruesit duhet të dorëzojnë informatat e mëposhtme për drejtorët dhe menaxherët e lartë.

- vendimin e organit vendimmarrës për këto emëime;
- raportin individual (CV sipas shtojcës A të këtij manuali) për personin e emëruar;
- kopjen e legalizuar/noterizuar të përgatitjes shkollore universitare;
- dëshmia zyrtare nga gjykata kompetente, që shpalos çdo dënim eventual për vepra penale dhe çdo procedurë penale, që mund të jetë duke u zhvilluar ndaj personit të propozuar;
- pëlqimin/autorizimin për verifikim të të kaluarës penale dhe marrjen e informacioneve tjera lidhur me informatat e paraqitura;
- informacione tjera shtesë të cilat mund të konsiderohen si të duhura nga BQK-ja.

Informatat që duhet të jepen në Formularin e Aplikacionit për secilin individ përfshijnë:

- titullin apo pozitën e veçantë të propozuar të siguruesi;
- emri dhe të dhënat e identifikimit;
- individët e ndërlidhur, kompanitë e ndërlidhura dhe partnerët e biznesit (vetëm për ata që aplikojnë si aksionarë aktual apo të mundshëm);
- edukimi;

- përvoja profesionale, përfshirë informatat aktuale të punësimit dhe informatat e punësimit të mëparshëm që duhet të përfshijnë së paku tri vite përvojë në sigurime apo në fushën e menaxhimit të institucioneve financiare apo të menaxhimit ndonjë biznesi të madhësisë së njëjtë;
- referencat profesionale;
- aplikacionet e mëhershme;
- pjesëmarrja në situatat problematike financiare;
- veprat penale dhe masat disiplinore;
- deklaratat financiare/vlera neto.

Për verifikim të përvojës dhe aftësisë paguese, përpos letër referencave si dokumente shtesë, BQK-ja mund të kërkoj nga kandidatet edhe dëshmitë nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) ose institucionet pensionale alternative dëshminë kronologjike të kontributeve pensionale sipas punëdhënësve, Vërtetimin e Tatimor (ATK) në lidhje me pagesën me kohë të obligimeve tatimore si dhe autorizim për lejimin e marrjes së informative nga Regjistri Kreditor i Kosovës (CRK) për ta verifikuar historikun kreditor.

Personi i propozuar duhet të nënshkruajë se informatat e lartpërmendura janë të vërteta dhe të sakta sipas njohurive të tij. Nëse ndonjë ndryshim material në aplikacion ndodh para vendimit të aplikacionit për licencë, individ duhet ta informojë BQK-në brenda pesë (5) ditëve prej ndryshimit të ndodhur. Nëse personeli i nevojshëm nuk është përcaktuar atëherë aplikuesit duhet ta ofrojnë një plan për llojin e kandidatëve d.m.th përvojën, edukimin për ata që do të punësohen në këto pozita.

Përveç asaj që u tha më lartë, drejtorët i nënshtrohen edhe kërkesave të mëposhtme:

- bordi i drejtorëve përbëhet nga numri tek prej jo më pak se pesë (5) anëtarë dhe të gjithë kanë të drejtë vote. Të gjithë drejtorët me të drejte vote duhet të jenë drejtor joekzekutiv;
- bordi i drejtorëve zgjedhet nga aksionarët e siguruesit dhe është përgjegjës për krijimin e politikave të tij, duke përfshirë politikat për menaxhim të riskut dhe për mbikëqyrjen e zbatimit të tyre;
- bordi i drejtorëve zgjedh kryesuesin nga radhët e anëtarëve të vet dhe vetëm kryeshefi ekzekutiv nuk mund të jetë kryesues;
- drejtorët përveç kryeshefit ekzekutiv zgjedhën për mandate prej jo më shumë se katër vite dhe mund të rizgjedhen për mandate vijuese;
- kryeshefi ekzekutiv shërben në bord sipas detyrës zyrtare dhe pa të drejtë vote, për aq kohë sa ai ose ajo e mban atë post;
- drejtoret dhe menaxherët e lartë duhet të shmangin interesat privat që krijojnë konflikt me interesat e siguruesit. Për këtë qëllim, duhet të jenë në pajtim me nenin 34 të Ligjit për Sigurimet;
- drejtoret dhe menaxherët e lartë duhet ta respektojnë detyrimin për mos konkurrencë sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare;
- bordi i drejtorëve nuk mund t'ia delegoj përgjegjësitë e veta të tjerëve; dhe

- emrat e drejtorëve futën në një regjistër që mbahet nga BQK-ja.

Sa i përket degëve të siguruesve të jashtëm, kriteret e përcaktuara më lartë në këtë pikë, aplikohen vetëm për menaxheret e lartë të degës së siguruesit të jashtëm në Kosovë.

2.2.4. Letra mbështetëse

Sipas nenit 10 paragrafi 1, nënparagrafi 1.10 të Ligjit për Sigurimet, në rastet kur aplikuesit janë të interesuar të themelojnë një degë apo subjekt të varur të një siguruesi të jashtëm, BQK kërkon nga aplikuesit një deklaratë nga mbikëqyrësi i vendit amë se nuk ka kundërshtim rreth fillimit të veprimtarisë së propozuar në Kosovë, dhe se ushtron mbikëqyrje globale siguruese të konsoliduar të veprimtarisë ndaj siguruesit të jashtëm. Në rastet kur legjislacioni i vendit amë të siguruesit të jashtëm kërkon miratim paraprak për rastet e hapjes së subjekteve të varura dhe degëve jashtë juridiksionit të tij, atëherë duhet të sjellët në BQK shkresa miratuese.

Gjithashtu në këto raste BQK kërkon edhe një letër mbështetëse nga siguruesi amë e aplikuesit për licencë, drejtuar BQK-së të formuluar minimalisht si në formën e mëposhtme: (BQK ja mund të kërkojë nga siguruesi amë që të freskojë këtë letër kohë pas kohe).

“Ne ju shkruajmë për të konfirmuar se [emri i siguruesit potencial] është një subjekt i varur në pronësi të plotë të [emri i siguruesit amë]. Struktura e bashkangjitur e grupit tregon zinxhirin e pronësisë në mes [emri i siguruesit amë] dhe [emri i siguruesit potenciale].

Është në interesin të [emri i siguruesit amë] se [emri i siguruesit potenciale] vazhdon të përmbushë gjatë gjithë kohës detyrimet dhe obligimet e saja që ka ndaj klientëve.

Prandaj ne e njohim përgjegjësinë mbi të dhe obligimet juridike të cilat mund të ekzistojnë për të mbrojtur stabilitetin financiar të saj. Përmes kësaj letre ju sigurojmë se [emri i siguruesit amë] është gjithmonë në gjendje të përmbushë detyrimet e [emri i siguruesit potenciale] dhe konfirmojmë se [emri i siguruesit amë] do të përmbushim këtë përgjegjësi.”

2.2.5. Dorëzimi i aplikacionit

Pas mbajtjes së takimit informues dhe shqyrtimit të fazës së aplikimit në këtë manual aplikuesit duhet të jenë të gatshëm të dorëzojnë aplikacionin formal për licencim si sigurues në BQK. Para se të dorëzohet aplikacioni, aplikuesit duhet ta rishikojnë atë për të kontrolluar nëse kanë dhënë përgjigje adekuate për të gjitha pyetjet dhe kanë bashkangjitur të gjitha dokumentet mbështetëse.

Është e rëndësishme që aplikuesit të kenë parasysh që gjithmonë të jenë të hapur dhe të sqartë me BQK-në, meqë suksesi i aplikimit do të ndikohet nëse BQK kupton që aplikuesit kanë mbajtur qëllimisht informacione ose kanë dhënë fakte të rreme ose jo të plota. Aplikuesit gjithashtu duhet të ndajnë me BQK-në ndonjë informacion tjetër që mendojnë se BQK duhet të jetë e vetëdijshme. Nëse aplikuesit janë në dyshim për ndonjë gjë, atëherë ata luten ta ndajnë atë me BQK-në. Gjithashtu, BQK ju rekomandon aplikuesve që t'i adresojnë të gjitha çështjet dhe veprimet që BQK ka identifikuar me ta gjatë fazës së para-aplikimit përpara se të dorëzojnë aplikacionin e tyre. Nëse informacioni që aplikuesit japin është i pasaktë, ose i paplotë, kjo, në minimum, do të vonojë aplikimin e tyre.

Aplikacionet për licencë si sigurues së bashku me dokumentacionin e plotë që kërkohet me nenin 10 të Ligjit për Sigurimet dhe Rregulloren për Licencimin e Siguruesve dhe Degëve të Siguruesve të Jashtëm, dorëzohen në formë të shkruar në BQK. Si pjesë përbërëse e aplikacionit duhet të plotësohet **Formulari i**

aplikimit për licencë të siguruesit që gjendet si Shtojcë 2 të këtij manuali si dhe në faqen zyrtare të BQK-së (www.bqk-kos.org). Aplikuesi duhet të dorëzojë në BQK formularin e plotësuar dhe të nënshkruar nga të gjithë aksionarët themelues, me prezencë fizike të përfaqësuesit me autorizim të aksionarëve themelues të siguruesit ose të siguruesit të jashtëm në rastet kur siguruesi i jashtëm, aplikon për licencimin e degës në Kosovë.

Dokumentacioni i ofruar si pjesë përbërëse e aplikacionit duhet të jetë në njërin nga dy gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, qoftë në origjinal ose në kopje të legalizuar. Në rastin e dokumentacionit të lëshuar nga autoritetet kompetente të një shteti të huaj, dokumentacioni duhet të jetë i legalizuar nga autoritetet përgjegjëse të atij shteti të huaj dhe në përputhje me dispozitat e akteve ligjore përkatëse të ligjeve të tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Për shqyrtimin e aplikacioneve për licencim si sigurues BQK-ja ka caktuar tarifa përkatëse bazuar në nenin 130 të Ligjit mbi Sigurimet. Të gjitha tarifat e kërkuara të aplikimit janë të paraqitura në Skemën e Tarifave që gjendet në ueb-faqen zyrtare të BQK-së dhe janë të pakompensueshme, pa marrë parasysh vendimin e BQK-së. Aplikacionet konsiderohen të pa kompletuara, dhe rrjedhimisht nuk shqyrtohen, nëse tarifa e licencimit nuk është paguar.

2.3. Faza e pas-aplikimit

Pas dorëzimit formal të aplikacionit për licencim si sigurues, BQK bën vlerësimin e parë ku verifikohet nëse aplikacioni i dorëzuar është i plotë ose jo. Që aplikacioni të vlerësohet i plotë, duhet të dorëzohet në BQK së bashku me të gjitha format e kërkuara (që janë edhe pjesë përbërëse të këtij manuali), të cilat duhet të jenë plotësuar plotësisht dhe në mënyrë korrekte dhe informacioni i ofruar duhet të jetë i cilësisë dhe detajeve të mjaftueshme për të lejuar BQK-së përfundimin e vlerësimit. Gjithashtu që të vlerësohet i plotë aplikacioni, duhet t'i ketë të inkuorporuara përgjigjet ndaj komenteve të BQK-së të ofruara gjatë fazës së para-aplikimit.

Në pajtim me nenin 9 të Rregullores për Licencimin e Siguruesve dhe Degëve të Siguruesve të Jashtëm, vlerësimi i parë bëhet nga BQK brenda nëntëdhjetë (90) ditësh pas ditës së pranimit të aplikacionit, dhe BQK e njofton aplikuesin me shkrim nëse dokumentacioni është apo nuk është i kompletuar. Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk është i kompletuar apo nëse kërkohen informata shtesë, BQK do ta njoftoj aplikuesin për mangësitë apo mospërputhjet me legjislacionin në fuqi së bashku me kërkesën për informata apo dokumentet shtesë që kërkohen. Gjatë kësaj periudhe, BQK mund të mbajë takim me aplikuesit për të marrë ndonjë informacion shtesë ose ndonjë ndryshim në lidhje me kërkesën. Gjatë këtyre takimeve do të mbahet procesverbale të cilat do të regjistrohen në dosjen e aplikacionit. Vlen të ceket që BQK-ja mund të kërkojë informata shtesë apo ndryshime/përmirësime të caktuara kur vlerësohen të arsyeshme në çfarëdo faze të procesit të licencimit.

Afati për paraqitjen e informatave apo dokumenteve shtesë është jo më vonë se nëntëdhjetë (90) ditë nga data e njoftimit. Nëse informatat apo dokumentet shtesë të kërkuara janë paraqitur brenda afatit, BQK do ta njoftoj palën se aplikacioni është i kompletuar. Në rast se të dhënat dhe/ose dokumentacioni i kërkuar për licencim nuk plotësohet nga aplikuesi brenda nëntëdhjetë (90) ditësh pas datës së njoftimit, BQK ndërpret procedurat e shqyrtimit të aplikacionit për licencim. Në rast të ndërprerjes së procedurës së shqyrtimit të aplikacionit për regjistrim, BQK-ja e njofton me shkrim aplikuesin.

2.3.1. Shqyrtimi i aplikacionit

Pas vlerësimit të parë të aplikacionit, verifikimit që aplikacioni është kompletuar si dhe informimit të aplikuesit për këtë çështje, BQK fillon me vlerësimin e dytë kur edhe bëhet shqyrtimi i thellë analitik i aplikacionit. Ky vlerësim i mundëson BQK-së përcaktimin nëse siguruesi i propozuar do të operojë në një mënyrë të sigurtë dhe të qëndrueshme dhe do të këtë mundësi të arsyeshme të suksesit. Vlerësimi bëhet nga Departamenti për Licencim dhe Standardizim si dhe nga Departamenti i Mbikëqyrjes së Sigurimeve, apo Divizioni i Raportimit dhe Analizave në Departamentin e Mbikëqyrjes së Sigurimeve përgjegjësia e të cilit është vlerësimi i Planit të Biznesit të siguruesit të propozuar duke marrë parasysh faktin që posedojnë të gjitha informatat dhe raportet analitike të industrisë së sigurimeve.

Vlerësimi gjithmonë do të bazohet në informatat e dorëzuara me aplikacion si dhe në informatat tjera që janë në dispozicion të BQK-së si rezultatet e veprimtarive të saj mbikëqyrëse. Gjithashtu, BQK-ja do të kërkojë referencat dhe mendimet e nevojshme nga autoritetet mbikëqyrëse vendore nga vjen siguruesi i propozuar apo vendet ku kompanitë e grupit janë prezente, kur kjo është e aplikueshme. Informacionet e marra nga BQK-ja gjatë hetimit mund të ndahen me rregullatorët tjerë të institucioneve financiare. Në rast të ndryshimi të informatave të dorëzuara në BQK, aplikuesi duhet të njoftojë BQK-në për ndryshimet e ndodhura pa marrë parasysh se në cilën fazë ndodhet aplikacioni për licencim.

Si rezultat i vlerësimit nëse BQK konstaton mangësi të vogla teknike, apo shpërputhje teknike me kërkesat rregullative, aplikuesi njoftohet për to dhe kërkohet që të ndryshohen në mënyrë që të bëhet i pranueshëm. Procesi i shqyrtimi përmbyllet me një raport rekomandues nga Departamenti për Licencim dhe Standardizim, të cilit i bashkohet edhe rekomandimin e Divizioni i Raportimit dhe Analizave në Departamentin e Mbikëqyrjes së Sigurimeve konform konkluzioneve të nxjerra nga vlerësimi i Planit të Biznesit të siguruesit të propozuar. Rekomandimi i paraqitet Zëvendësguvernatorit për Mbikëqyrje Financiare, i cili më pastaj përmes Zëvendësguvernatorit për Mbikëqyrje Financiare mandej i ofrohet Bordit Ekzekutiv të BQK-së për vendimarrje.

2.4. Miratimi paraprak

BQK paraprakisht miraton ose refuzon kërkesën për licencë të një siguruesi të propozuar/dege të siguruesit të jashtëm të propozuar, brenda tre (3) muajve nga data e njoftimit se aplikacioni për licencim është i kompletuar, siç është e përcaktuar me nenin 11 paragrafi 1 të Ligjit për Sigurimet dhe Rregulloren për Licencimin e Siguruesve dhe Degëve të Siguruesve të Jashtëm. Për vendimin e marrë BQK-ja menjëherë e informon aplikuesin. Sipas legjislacionit në fuqi, Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore ka kompetencën të miratojë ose ta refuzojë dhënien e licencave ose të lejeve për sigurues, si dhe t'i revokojë këto licenca dhe leje. Në rastet e refuzimit të licencës, BQK-ja duhet të cekë arsyet mbi bazë të së cilave është refuzuar licenca.

Sipas nenit 11 paragrafi 2 të Ligjit për Sigurimet, BQK-ja do të refuzojë një licencë, nëse nuk përmbushen kriteret e përcaktuara me Ligjin për Sigurime, nëse aplikuesi qëllimisht ka ofruar dokumentacion të falsifikuar dhe nëse gjykon se lëshimi i një licence të këtillë do të:

- vinte në rrezik qëndrueshmërinë financiare të siguruesit të propozuar ose të industrisë së sigurimeve në përgjithësi;
- rrezikonte interesat e policëmbajtesve të siguruesit të propozuar.

Gjithashtu, BQK-ja do refuzoj licencimin e nje siguruesit ose dege të një siguruesi të jashtëm nëse nuk përmbushen kriteret e përcaktuara me Rregulloren për Licencimin e Siguruesve dhe Degëve të Siguruesve të Jashtëm dhe këtë manual.

Sipas nenit 11 paragrafi 3 të Ligjit për Sigurimet, BQK paraprakisht miraton një licencë vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

- nëse plani i biznesit bazohet në analiza të sakta dhe në supozime të arsyeshme;
- struktura organizative e siguruesit të propozuar dhe degëve të tij do t'i lejojë BQK-së të ushtrojë mbikëqyrje efektive dhe të konsoliduar;
- primet e llogaritura dhe provizionet teknike ose matematike janë të mjaftueshme për mbulimin e përgjegjësive të siguruesit;
- siguruesi i propozuar do të veprojë në pajtueshmëri me të gjitha dispozitat e këtij ligji;
- kualifikimet, përvoja dhe integriteti i drejtorëve apo menaxherëve të saj të lartë janë të përshtatshëm për planin e biznesit të siguruesit të propozuar dhe veprimtarive të sigurimit;
- aksionarët kryesorë, drejtorët dhe menaxherët e lartë të siguruesit të propozuar janë të përshtatshëm dhe të duhur, siç përcaktohet me nenin 24 të këtij Ligjit për Sigurimet dhe përcaktimeve tjera nga BQK-ja, dhe;
- struktura e pronësisë së siguruesit, nuk do të pengoj mbikëqyrjen efektive prej BQK-së.

Përveç kushteve të përcaktuara më lartë, miratimi paraprak i kërkesës për licencë lidhur me një subjekt të varur ose degë të siguruesit të jashtëm bëhet vetëm nëse:

- siguruesi i jashtëm është i licencuar për t'u angazhuar në veprimtarinë e sigurimit në juridiksionin ku gjendet drejtoria e saj qendrore;
- autoriteti mbikëqyrës përgjegjës ku ka selinë qendrore siguruesi i jashtëm, ka dhënë pëlqimin e tij me shkrim për dhënien e licencës së këtillë, dhe;
- BQK-ja vlerëson se siguruesi i jashtëm mbikëqyret në mënyrë adekuate në bazë të konsoliduar nga autoriteti mbikëqyrës përgjegjës në shtetin amë. Autoriteti mbikëqyrës përgjegjës nga shteti amë, duhet ta pranojë me shkrim se është në dijeni të dhënies së licencës së re dhe pajtohet që t'i ofrojë informata BQK-së me kërkesë të saj.

Në rast të miratimit paraprak të një kërkesë për licencë, BQK i përcakton të gjitha kushtet për siguruesin të cilës i jepet licenca për fillimin e operacioneve të saj. Kushte e këtilla mund të përfshijnë:

- pagesën e kapitalit fillestar që aksionarët duhet të bëjnë për siguruesin;
- punësimin dhe trajnimin e personelit të siguruesit;
- blerjen e pajisjeve operative dhe përcaktimin e sistemeve operative;
- marrjen me qira, blerjen ose zotërimin e lokaleve të siguruesit;

- primet e llogaritura dhe provizionet teknike ose matematike janë të mjaftueshme për mbulimin e përgjegjësive të siguruesit;
- draft-kontratat e sigurimit sipas klasave ku siguruesi kërkon të licencohet;
- angazhimin e një auditori të jashtëm dhe aktuari në përputhje me Ligjin për Sigurimet;
- çdo kusht tjetër që BQK-ja e konsideron të përshtatshëm.

Nëse brenda një (1) viti siguruesi nuk vepron në përputhje me kushtet për marrjen e licencës për fillimin e veprimtarisë, miratimi paraprak i kërkesës do të revokohet.

Aplikuesi duhet të fillojë organizimin e siguruesit sapo të marrë njoftimin për miratimin paraprak nga ana e BQK-së. Megjithatë, puna e siguruesit nuk mund të fillojë deri sa të jepet një licencë përfundimtare.

3. LICENCIMI

Ky kapitull shpjegon fazën e dhënies së licencës për sigurues si fazë përfundimtare e procesit të licencimit. Kapitulli fillon me hapat që aplikuesi duhet ti ndërmarr me marrjen e miratimit paraprak, pastaj vazhdon sqarimin e procesit të ekzaminimit të para-hapjes ku BQK verifikon përmbushjen e kriterëve të para-përcaktuara si dhe përmbillet me hapin final dhënien e licencës për sigurues.

Pas marrjes së miratimit paraprak aplikuesi duhet të fillojë me organizimin e siguruesit të propozuar dhe përmbushjen e kushteve të përcaktuara nga BQK me vendimin për miratimin paraprak të licences. Aplikuesi do t'i ketë 1 (një) vit kohë nga data e miratimit paraprak të kërkesës për licencim për të kompletuar organizimin e siguruesit të propozuar. Gjatë fazës së organizimit, siguruesi punëson pjesën tjetër të personelit të saj, themelon mjediset e saj siguroese në vendet e propozuara, paguan kapitalin, zhvillon sistemet e saj për zhvillim të veprimtarisë siguroese, etj. Dështimi që të kompletohet organizimi brenda kësaj periudhe do të shkaktojë revokimin e miratimit paraprak të licencës.

Në rast të ndryshimeve të informatave, mbi bazën e të cilave, BQK ka lëshuar miratimin paraprak, aplikuesi për licencë njofton me shkrim BQK-në për faktet ose rrethanat e reja të krijuara. Ky njoftim duhet t'i dërgohet BQK-së menjëherë pasi krijimit të rrethanave të reja, por jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas paraqitjes së tyre. Nëse ndryshimet që shfaqen gjatë fazës së organizimit ndryshojnë në mënyrë thelbësore faktet në të cilat BQK-ja e ka bazuar miratimin e saj paraprak, ai miratim mund të revokohet.

Revokimi i miratimit paraprak mund të rezultojë nga ndryshimet në:

- përbërjen e grupit organizues;
- kryeshefin ekzekutiv;
- shpërndarjen e pronësisë;
- informata negative mbi aksionarët kryesor, drejtorët dhe menaxherët e lartë që nuk janë shpalosur më parë;
- gjendjen financiare të aplikuesve;

- gjendjen e kompanisë amë si kompani garantuese;
- gjendjen e filialeve ose kompanive të sigurimeve pjesëmarrëse;
- përmbajtjes së planit operativ.

Megjithatë, BQK mund ti pranojë propozimet për ndryshimet e vogla sidomos ndryshimet të cilat mund të jenë të dobishme për siguruesin në themelim. Mirëpo për këtë qëllim të gjitha ndryshimet e propozuara shqyrtohen për nga rëndësia dhe efektet e tyre mbi bazën e përdorur për të dhënë miratimin paraprak.

3.1. Aplikimi për licencë

Pas plotësimi të kriterëve të përcaktuara me marrjen e miratimit paraprak për licencë, siguruesi duhet të aplikojë me shkrim në BQK për marrjen e licencës përfundimtare. Siç është sqaruar edhe më lartë, aplikacioni për licencë përfundimtare i cili dëshmon përmbushjen e kriterëve nga ky paragraf duhet të jetë i kompletuar brenda një (1) viti nga data e miratimit paraprak. Aplikuesit janë të inkurajuar që të përmbushin të gjitha kriteret e përcaktuara në vendimin për miratimin paraprak të kërkesës për licencë dhe të aplikojnë për licencë përfundimtare në një afat sa më të shkurtër. Ky inkurajim bëhet me qëllim që të evitohen problemet potenciale sa i përket kompletimit të dokumentacionit si dhe sqarimeve shtesë lidhur me këtë proces që ndikojnë në vendosjen për licencën përfundimtare, pasi që çdo plotësim apo sqarim shtesë duhet të bëhet duke respektuar afatin një (1) vjeçar të përcaktuar më lartë. Gjithashtu kjo ndikon edhe mundësinë e pajisjes sa më të shpejtë me licencë përfundimtare, prandaj, si rrjedhim i gjithë procesi i shqyrtimit dhe vendosjes për licencë përfundimtare është i ndikuar nga dinamika e veprimit të aplikantit lidhur me përmbushjen e kriteret e vendimit për miratimin paraprak të kërkesës për licencë.

Aplikimi formal bëhet duke paraqitur dokumentacionin e mëposhtëm:

- kërkesën me shkrim si dhe një përshkrim të shkurtër se kur planifikohet hapja;
- dokumentin bankar që vërteton pagimin e shumës së kapitalit fillestar minimal (kapitali themeltar) sipas kushteve të përcaktuara në nenin 19 të Ligjit për Sigurimet dhe Rregulloren për Licencimin e Siguruesve dhe Degëve të Siguruesve të Jashtëm;
- Aktet nënligjore/statuti i siguruesit; kontratat, duke përfshirë kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës së sigurimit në përputhje me klasën e sigurimit për të cilën ka kërkuar të licencohet;
- dokument valid për fitimin e të drejtës së përdorimit të ambienteve ku do të zhvillohet veprimtaria siguruese. Lokalet duhet të jenë të legalizuara dhe të kenë dokumentacionin e duhur nga autoritetet kompetente;

Aplikacioni për licencë përfundimtare përfshinë dokumentet e cekura më lartë si dhe kushtet standarde (të detajuar më poshtë) për funksionimin e një siguruesi. Kushtet standarde caktojnë pikat më të rëndësishme që aplikuesi dhe siguruesit e rinj duhet t'i monitorojnë, shumë nga të cilat janë inkorporuar në ekzaminimin para hapjes të sqaruar më poshtë.

Kushtet standarde përfshijnë:

- punësimin dhe trajnimin e personelit të siguruesit (shqyrtojë numrin dhe përvojën e personelit të siguruesit ndërlidhur me vëllimin e pritur të biznesit);

- marrja me qira apo blerja e pajisjeve për operim dhe themelimin e sistemit operativ, përfshirë kontrollin dhe auditorin e brendshëm, instalimin adekuat të pajisjeve dhe procedurave të sigurisë etj;
- angazhimin e një auditori të jashtëm;
- një rishikim të politikave të shkruara për menaxhim të rrezikut (monitorim, menaxhim, kontrollim dhe raportim);
- ndarje efektive të detyrave;
- procedurat efektive për kontabilitet dhe raportim;
- procedurat efektive për kontroll dhe mbajtje të sendeve (holdover);
- procedurat adekuate për parandalimin e pastrimit së parave dhe luftimin e terrorizmit në pajtim me ligjet, rregulloret, udhëzimet, urdhrat dhe procedurat kundër pastrimit të parave dhe luftimit të terrorizmit;
- një rishikim të sistemit të TI-së në lidhje me operacionet, përfshi ofruesit e shërbimeve të TI-së, ofruesit e TI-së për ruajtje (backup) dhe plani për vazhdimësinë e biznesit në një lokacion alternativ; dhe
- çfarëdo kushtesh tjera që BQK-ja i konsideron si të duhura.

3.2. Ekzaminimi i parahapjes

Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e plotësimit të dokumentacionit të kërkuar sipas nënkapitullit 3.1 të këtij kapitulli, BQK kryen ekzaminimi para-hapjes (EPH) së siguresit në themelim. EPH është hapi i fundit i procesit të licencimit të një siguresi i cili realizohet nga BQK që të përcaktohet se a janë plotësuar të gjitha kushtet për fillim të veprimtarisë. Ekzaminimi realizohet nga Departamenti për Licencim dhe Standardizim në bashkëpunim me Departamentin për Mbikëqyrjen e Sigurimeve në BQK.

Pas realizimit të EPH, ekipi ekzaminues përgatit raportin lidhur me plotësimin e kushteve për fillimin e biznesit sigures të EPH konstaton se nuk janë plotësuar të gjitha kushtet teknike dhe të sigurisë apo ekzistojnë përjashtime të shumta ose shmangie të konsiderueshme nga miratimi paraprak, BQK do e njoftoj siguresin në themelim së bashku me kërkesën për plotësimin e këtyre kushteve apo korrigjimin e shmangieve të konstatuara. Afati për plotësimin e kushteve apo korrigjimeve të shmangieve do të jetë dhjetë (10) ditë nga data e njoftimit. Nëse nuk bëhet plotësimi i kushteve apo korrigjimi i shmangieve brenda afatit të përcaktuar më lartë miratimi paraprak mund të revokohet.

3.3. Dhënia e Licencës

Brenda katërdhjetë e pesë (45) ditëve nga data e EPH, BQK merr vendim me anë të së cilit miraton apo refuzon dhënien e licencës përfundimtare të një siguresi apo degë të siguresit të jashtëm. Nëse BQK-ja konstaton se janë plotësuar kushtet e përcaktuara në nenin 11 paragrafi 5 të Ligjit për Sigurimet dhe kriteret tjera të përcaktuara me Rregulloren për Licencimin e Siguresve dhe Degëve të Siguresve të Jashtëm si dhe me vendimin për miratim paraprak, do ta jap licencën.

Sipas nenit 29 paragrafi 2 të Ligjit nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, Siguresi nuk mund të ushtrojë veprimtarinë e sigurimit të detyrueshëm të autopërgjegjësive pa qenë

anëtar i Byrosë Kosovare të Sigurimeve. Bazuar në këtë fakt, siguruesi i licencuar për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia, duhet të anëtarësohet në Byronë Kosovare të Sigurimeve para se të filloj veprimtarinë siguroese për këte klasë të sigurimeve.

4. MIRATIMET E TRANSAKSIONEVE TJERA

Ky kapitull rregullon transaksionet të cilat realizohen pas licencimit të siguruesit dhe fillimit të operacioneve të tij e që për të cilat kërkohet miratim paraprak nga ana e BQK-së për të cilat është përcaktuar gjithashtu edhe dokumentacioni i kërkuar nga BQK për miratimin e këtyre transaksioneve, afatet si dhe procedura e shqyrtimit. Kapitulli përfundon me specifikimin e transaksioneve për të cilat nevojitet vetëm njoftimi i BQK-së.

Sipas Ligjit për Sigurimet, transaksionet në vijim të siguruesve në Kosovë, kërkojnë miratim paraprak nga BQK:

- ndryshimi i emrit të siguruesit;
- ndryshimet në aktin e themelimit dhe/apo statutit;
- ndryshimi në kapital;
- aksionarët kryesor;
- emërimi i drejtorëve dhe menaxherëve të lartë;
- zgjerimi i veprimtarisë;
- hapja dhe zhvendosja e degëve dhe zyrave brenda vendit;
- mbyllja e degëve dhe zyrave brenda vendit;
- hapja e degëve dhe subjekteve të varura jashtë vendit;
- auditori i jashtëm;
- transferimi i portofolit të sigurimit;
- delegimi i funksioneve;
- bashkimet dhe përvetësimet e siguruesve;
- përvetësimet e interesit të kapitalit nga siguruesit në institucionet financiare.

Kërkesa për miratimin e transaksioneve të lartcekura si dhe dokumentacioni i bashkangjitur në kërkesë duhet të paraqitet nga siguruesi dhe duhet të jetë në një nga dy gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, qoftë në origjinal ose në kopje të legalizuar. Brenda tridhjetë (30) ditëve pas ditës së pranimit të kërkesës së kompletuar për miratimin e ndonjërit nga transaksionet e cekura më lartë transaksionet, BQK-ja miraton apo refuzon kërkesën e tillë.

Në rastet kur kërkesa nuk është e kompletuar apo kërkohen informata shtesë, BQK do ta njoftoj aplikuesin për mangësitë apo mospërputhjet me legjislacionin në fuqi së bashku me kërkesën për informata apo dokumentet shtesë që kërkohen. Afati për paraqitjen e informatave apo dokumentetve

shtesë është jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data e njoftimit. BQK ndërpret procedurat e shqyrtimit të kërkesës përkatëse në rast se të dhënat dhe/ose dokumentacioni i kërkuar nuk plotësohet nga siguruesi brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas datës së njoftimit. Në rast të ndërprerjes së procedurës së shqyrtimit të kërkesës, BQK-ja e njofton me shkrim siguruesin.

Pasi që kërkesa të konsiderohet e kompletuar BQK e shqyrton dhe vendos për atë kërkesë duke u bazuar në dispozitat ligjore të cilat janë përshkruar me poshtë në këtë kapitull varësisht nga natyra e transaksionit. Për vendimin e marrë BQK-ja menjëherë e informon siguruesin. Në rastet e refuzimit, njoftimi për refuzimin e kërkesës do t'i përmbajë arsyet për të cilat është refuzuar kërkesa.

4.1. Ndryshimi i emrit

Ndryshimi i emrit të siguruesit kërkon miratim paraprak nga BQK, sipas nenit 43 të Ligjit për Sigurimet. Për miratimin e ndryshimit të emrit, siguruesi duhet të dorëzojë në BQK, kërkesë me shkrim duke i bashkangjitur dokumentet e mëposhtme:

- vendimin e organit vendimmarrës për ndryshim emri; si dhe
- dokumentet për arsyetimin e këtij ndryshimi.

Ndryshimi i emrit, respektivisht emri i ri i propozuar i siguruesit duhet të jete në pajtim me Ligjin për Sigurimet, Ligjin për Shoqëritë Tregtare si dhe Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve. Brenda tridhjetë (30) ditësh kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së kompletuar për licencë të degës, BQK-ja do të miratojë apo refuzojë kërkesën për ndryshimin e emrit.

4.2. Ndryshimet në aktin e themelimit dhe/apo statutin

Akti i themelimit dhe statuti janë dokumentet apo aktet të cilat shërbejnë për themelimin, organizimin dhe qeverisjen e siguruesit. Të gjithë siguruesit që ushtrojnë veprimtari sigurimi në Kosovë, përveç degës së siguruesit të jashtëm të licencuar në Kosovë, nuk mund të ndryshojë aktin e saj të themelimit ose statutin pa miratimin paraprak, me shkrim, të BQK-së, siç edhe përcaktohet me nenin 23 të Ligjit për Sigurimet thekson se një kopje e të cilave duhet të miratohet nga BQK-ja. Dega e siguruesit të jashtëm e licencuar në Kosovë, duhet ta njoftojë BQK-në për çdo ndryshim në aktin e saj të themelimit, statutin apo në dokumentacionin ekuivalent të themelimit brenda tridhjetë (30) ditëve nga data efektive e ndonjë ndryshimi.

Për miratimin e ndryshimeve në aktin e themelimit dhe/apo statutit, siguruesit duhet të dorëzojnë kërkesë me shkrim në BQK së bashku me informatat e mëposhtme:

- një përshkrim të shkurt të pikave që propozohet të ndryshohen si dhe një arsyetim se për çfarë arsye po ndryshohen;
- vendimin e asamblesë së aksionarëve për këto ndryshime;
- aktin e themelimit dhe/ose statutin pas ndryshimeve.

BQK miraton ndryshimet e propozuara në rast se këto ndryshime nuk janë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi brenda tridhjetë (30) ditësh kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së kompletuar.

4.3. Ndryshimi në kapital

Sipas nenit 42 të Ligjit për Sigurimet, çdo ndryshim i kapitalit të siguruesit, i nënshtrohet miratimit paraprak nga BQK-ja. Në rastin e rritjes së kapitalit, siguruesi dorëzon në BQK, të dhëna për burimin e kapitalit. Nëse rritja e kapitalit të siguruesit bëhet nga burime të brendshme të tij, siguruesi dorëzon në BQK të dhënat e kërkuara në lidhje me burimin e rritjes së kapitalit përfshirë edhe një vërtetim të lëshuar nga auditori i jashtëm i siguruesit, që vërteton mjaftueshmërinë e këtyre burimeve brenda strukturës së siguruesit.

BQK-ja mund të kërkoj dokumentacion dhe sqarime shtesë në rastet kur të dhënat e dorëzuara nga siguruesit për burimin e kapitalit janë të pamjaftueshme ose nëse ka paqartësi në lidhje me burimin e kapitalit.

4.4. Aksionarët kryesor

Struktura e pronësisë së një siguruesi është me interes të veçantë, prandaj BQK do të vlerësojë, këtë strukturë si tërësi si dhe përshtatshmërinë individuale të aksionarëve kryesor ekzistues si dhe atyre potencial të cilët synojnë të jenë pronar të aksioneve në siguruesi. Neni 35 i Ligjit për Sigurimet thekson se Zotërimi i aksioneve në një sigurues, ku një aksionar drejtpërsëdrejti ose tërthorazi arrin ose tejkalon nivelin e të qenit aksionar kryesor, bëhet vetëm me miratim paraprak të BQK-së pas paraqitjes së kërkesës për të qenë aksionar kryesor. Gjithashtu BQK-ja miraton çdo zotërim të mëtejme të aksioneve që janë të barabarta ose tejkalojnë dhjetë përqind (10%), njëzetpërqind (20%), tridhjetë përqind (30%) dhe pesëdhjetë përqind (50%) të drejtave të votës ose pjesëmarrjes në kapitalin e siguruesit.

Kërkesat për përvetësim të interesit të kapitalit në një sigurues apo ngritjes së posedimit të interesave të kapitalit në një sigurues duhet të bëhen në formë të shkruar dhe të dorëzohen në BQK së bashku me informatat e mëposhtme:

- raportin e kompanisë aksionare (RK) apo CV-të e aksionarëve individual që gjinden te Shtojca B dhe C e këtij manuali;
- emrin, nacionalitetin, vendbanimin dhe historikun afarist the profesional për dhjetë (10) vitet e fundit të paraqitësit të kërkesës, dhe çdo pronari përfitues të paraqitësit të kërkesës, që si rezultat i transaksionit, do të përfitonte në mënyrë indirekte pesë përqind (5%) ose më shumë të interesave të kapitalit të siguruasit;
- listën e sipërmarrjeve në të cilat pronarët e propozuar, duke përfshirë pronarët përfitues (siç përshkruhet me lartë), kanë pjesëmarrje, duke specifikuar nivelin e pjesëmarrjeve të këtilla dhe adresat e regjistruara të këtyre sipërmarrjeve;
- për çdo person fizik që bën kërkesë, një deklaratë nga Gjykata që shpalos ndonjë dënim për vepra penale nga një gjykatë penale, dosjet personale të falimentimit, përjashtimi nga ushtrimi i profesionit, apo përfshirjen e tanishme a të kaluar në funksion menaxhues të një korporate ose të ndonjë sipërmarrësi tjetër që i nënshtrohet procedurës së paaftësisë së pagesës, nëse ekziston;
- për çdo person juridik kandidat, pasqyrat e audituara financiare për tri (3) vitet e fundit;
- afatet dhe kushtet e përvetësimit të propozuar;
- burimin dhe shumën e fondeve që shfrytëzohen në ushtrimin e përvetësimit;

- çdo plan ose propozim lidhur me ndryshimin kryesor në biznesin, strukturën e korporatës ose menaxhmentin e siguruesit;
- në çdo rast kur përvetësimi i aksioneve do të ndikonte që siguruesi të bëhet një subjekt i varur i një siguruesi të jashtëm, një deklaratë nga autoriteti mbikëqyrës përgjegjës i vendit amë se nuk ka kundërshtime për fillimin e veprimtarisë në Kosovë dhe se ushtron mbikëqyrje globale të konsoliduar ndaj siguruesit të jashtëm; dhe
- informata të tjera që mund të kërkohen nga BQK-ja.

Gjatë vendosjes për të miratuar një kërkesë për përvetësim të interesit të kapitalit në një siguruesit, BQK-ja vlerëson përvetësimin e propozuar sipas kriterëve të njëjta që zbatohen për miratimin paraprak apo përfundimtar të një kërkesë për licencë duke përfshirë por duke mos u kufizuar në efektet e pritura të përvetësimit të propozuar në qëndrueshmërinë financiare e siguruesit, strukturën rezultuese të pronësisë së siguruesit dhe efektin e saj në mundësinë e BQK-së për të kryer një mbikëqyrje ekskluzive dhe të konsoliduar dhe përshtatshmërinë e aksionarëve të propozuar dhe pozicionin e tyre në tregjet financiare.

BQK-ja mund t'i miratojë aksionarët kryesorë, nëse plotësohen kërkesat e parashikuara në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe refuzon miratimin për aksionarët kryesorë nëse gjykon se:

- veprimet e kryera në të kaluarën nga aksionari kryesor apo personat/palët e ndërlidhura me të mund të përkeqësojnë veprimtarinë e siguruesit në lidhje me rregullat e menaxhimit të rrezikut apo mund të vështirësojnë ose bëjnë të pamundur ushtrimin e mbikëqyrjes nga BQK-ja;
- në rastin e kërkesës nga aksionarët kryesorë të jashtëm, zbatimi i legjislacionit apo praktikave të legjislacionit të vendit të tij, vështirësojnë ose bëjnë të pamundur ushtrimin e mbikëqyrjes nga BQK-ja.
- BQK-ja, nëse gjykon se një person, i cili është aksionar kryesor në një sigurues vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij Ligji dhe me rregullat për menaxhimin e kujdesshëm e të përshtatshëm të siguruesit, merr masat e duhura për përfundimin e kësaj situate.

Siguruesi gjithashtu duhet ta njoftojë BQK-në për çdo përvetësim të aksioneve brenda 5 ditëve pas përvetësimit të shumës së aksioneve që është e barabartë ose tejkalon pesë përqind (5%) të kapitalit por që nuk tejkalon përqind (10 %) të tij. Njoftimi bëhet në atë mënyrë që përmban informacionet që mund të kërkohen nga BQK-ja.

BQK miraton ndryshimet e propozuara në rast se këto ndryshime nuk janë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi brenda tridhjetë (30) ditësh kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së kompletuar.

4.5. Emërimi i drejtorëve dhe menaxherëve të lartë

Çdo sigurues menaxhohet nga Bordi i Drejtorëve dhe Menaxhmenti i lartë. Përbërja e Bordit të Drejtorëve dhe Menaxhmentit të lartë është shumë i rëndësishëm për suksesin e një siguruesi. Prandaj, sipas nenit 33 të Ligjit për Sigurimet është përcaktuar se se asnjë person nuk mund të ushtroj funksionin e anëtarit të bordit të drejtorëve apo menaxherit të lartë të një siguruesi pa marrjen e miratimit paraprak nga BQK-ja. Për miratimin e drejtorëve dhe menaxherëve të lartë, siguruesit duhet të dorëzojnë kërkesë me shkrim në BQK së bashku me informatat e mëposhtme (referojuni shtojcave A të këtij manuali).

- vendimin e organit vendimmarrës për këto emëtime;
- raportin individual (CV sipas shtojcës A të këtij manuali) për personin e emëruar;
- kopjen e legalizuar/noterizuar të përgatitjes shkollore universitare;
- dëshminë zyrtare nga gjykata kompetente, që shpalos çdo dënim eventual për vepra penale dhe çdo procedurë penale, që mund të jetë duke u zhvilluar ndaj personit të propozuar;
- pëlqimin/autorizimin për verifikim të të kaluarës penale dhe marrjen e informacioneve tjera lidhur me informatat e paraqitura;
- informacione tjera shtesë të cilat mund të konsiderohen si të duhura nga BQK-ja.

Drejtorët dhe menaxherët e lartë të propozuar të siguruesve, duhet të plotësojnë kriterin “i përshtatshëm dhe të duhur” dhe kriterin për pavarësi për miratimin fillestar si pjesë e procesit të licencimit ashtu siç është sqaruar edhe në kapitullin 3 të këtij manuali. Këto kritere duhet të plotësohen në vazhdimësi për gjatë gjithë kohës deri sa drejtorët dhe menaxherët të siguruesve mbajnë pozitat e tyre në një kompani sigurimi.

Gjithashtu për qëllim të vlerësimit të personave të propozuar si drejtor dhe menaxher të lartë, BQK-ja i përdorë kriteret e mëposhtme për të bërë vlerësimin para se të japë miratimin e saj për çdo individ të propozuar si drejtor apo menaxher i lartë:

- nuk është larguar nga posti në një siguruesi nga BQK-ja; ose nuk është dënuar nga një gjykatë penale për vepër penale me 6 muaj ose me shumë burg, me vendim të formës së prerë;
- nuk është përjashtuar ose suspenduar nga autoriteti kompetent nga ushtrimi i profesionit.;
- nuk ka qenë drejtor ose menaxher i lartë i një siguruesi licenca e së cilës është revokuar apo paaftësia e pagesës ose likuidimi i detyruari tjetër jo vullnetar i së cilës është iniciuar gjatë mandatit të atij drejtori ose menaxheri të lartë.
- Përveq siç përcaktohet me nenet 24 dhe 32 të Ligjit për Sigurimet dhe Rregulloren për Licencimin e Siguruesve dhe Degëve të Siguruesve të Jashtëm, BQK-ja do të vlerësoj drejtorët dhe menaxherët e lartë të siguruesve edhe në bazë të kritereve të mëposhtme:

Integriteti – Historia personale e drejtorëve dhe menaxherëve të lartë të mundshëm duhet të dëshmojë se ata janë plotësisht të pavarur dhe se posedojnë kualitete personale, në rend të parë integritetin që është i nevojshëm për t’i kryer detyrat e tyre;

- **Gjykim** – Drejtorët dhe menaxherët e lartë duhet të kenë kualifikimet e duhura formale dhe aftësi personale që i japin mundësi atyre, që në mënyrë kritike dhe adekuate të vlerësojnë politikat e rëndësishme dhe çështjet strategjike, me të cilat do të ballafaqohet siguruesi dhe të artikulojnë qartë pikëpamjet e tyre mbi çështjet e tilla;
- **Udhëheqja** – Drejtorët dhe menaxherët e lartë duhet të kenë përvojë të mjaftueshme të udhëheqjes në biznes;
- **Kompetenca** – drejtorët dhe menaxherët e lartë të siguruesve duhet të kenë diplomë universitare në ndonjë nga fushat si në vijim: ekonomi, financa, sigurime, jurisprudencë ose fushë tjetër

relevante, si dhe të kenë së paku tri vite përvojë në fushën e menaxhimit të sigurimeve, të menaxhimit të institucioneve financiare apo të menaxhimit ndonjë biznesi të madhësisë së njëjtë;

- **Qëndrueshmëria financiare** – Drejtorët dhe menaxherët e lartë duhet të dëshmojnë përmbushjen me kohë të obligimeve financiare;
- **Mjedis ligjor** – njohuri të kornizës ligjore sipas të cilës operojnë siguruasit në Republikën e Kosovës.

Gjithashtu, BQK-ja mund të zgjedhë të intervistojë ndonjë drejtor apo menaxher të lartë të propozuar.

Sipas nenit 32 paragrafi 4 të Ligjit për Sigurimet një person nuk mund të emërohet apo të zgjidhet si drejtor ose menaxher i lartë i siguruasit, nëse ai person ka shërbyer në çfarëdo kohe gjatë gjashtë (6) muajve të mëparshëm në BQK.

Duke pasur parasysh që Ligji për Sigurime kërkon miratim nga BQK edhe për emërimin e ekspertëve të jashtëm nga fusha e kontabilitetit ose auditimit në komitetin e auditimit (anëtari i jashtëm i komitetit të auditimit), atëherë të gjitha kërkesat e cekuar më lartë do të zbatohen edhe në rastin e vlerësimit të kërkesave për miratimin e tyre.

Kërkesat për drejtorë duke përfshirë edhe ekspertin e jashtëm nga fusha e kontabilitetit ose auditimit në komitetin e auditimit të cekura më lartë në këtë pikë nuk aplikohen për siguruasit e jashtëm që është e licencuar për të operuar me një ose më shumë degë në Kosovë.

BQK miraton ndryshimet e propozuara në rast se këto ndryshime nuk janë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi brenda tridhjetë (30) ditësh kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së kompletuar.

4.6. Zgjerimi i veprimtarisë

Sipas nenit 17 të Ligjit për Sigurimet, siguruasi i cili ka marrë licencë për të ushtruar veprimtari në klasa të caktuara të sigurimit dhe që kërkon të ushtrojë veprimtari në klasa të tjera të sigurimit, duhet të marrë licencë për zgjerim veprimtarie për klasat që dëshiron të licencohet. Kjo çështje me tutje trajtohet me Rregulloren për Licencimin e Siguruesve dhe Degëve të Siguruesve të Jashtëm.

Kërkesës për zgjerim veprimtarie (licencim të klasave tjera të sigurimeve), duhet ti bashkëngjitet dokumentacioni si në vijim:

- Vendimin e organeve kompetente të siguruasit për zgjerim të veprimtarisë;
- Draft-kontratata, duke përfshirë kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës së sigurimit në përputhje me klasën e sigurimit për të cilën ka kërkuar të licencohet;
- Politikat e marrjes në sigurim për klasën përkatëse;
- Primet dhe mënyrën e kalkulimit të tyre;
- Parashikimin për tri vitet e ardhshme të veprimtarive shtesë përfshirë projeksionet financiare si dhe një vlerësim mbi ndikimin e kësaj veprimtarie në gjendjen e përgjithshme financiare të siguruasit.

Në rastet e degëve të siguruesve të jashtëm, licencimi i veprimtarisë shtesë mund të bëhet vetëm nëse siguruesi është i licencuar për këtë veprimtari nga autoriteti mbikëqyrës përgjegjës i vendit ku ka selinë siguruesi.

Sipas vlerësimit të saj BQK-ja mund të kërkoj edhe dokumentacion tjetër për qëllime të shqyrtimit të kërkesave nga ky nen. Afati për shqyrtimin e kërkesës së kompletuar të përcaktuar në fillim të këtij kapitulli nuk aplikohet për kërkesat për zgjerim të veprimtarisë së siguruesit.

BQK-ja vendos për kërkesën për zgjerim veprimtarie brenda katërdhjetë e pesë (45) ditësh nga data e kompletimit të kërkesës.

4.7. Hapja dhe zhvendosja e degëve dhe zyrave brenda vendit

Siguruesi i cili vendos të themelojë ose të zhvendosë një degë ose zyrë brenda vendit, përfshirë zhvendosjen e zyrës qendrore, duhet të dorëzojë një aplikacion në BQK dhe të marrë miratimin paraprak, në pajtim me nenin 14 paragrafi 1 të Ligjit për Sigurimet.

Sipas Rregullores për Hapjen dhe Mbylljen Brenda dhe Jashtë Kosovës të Degëve dhe Subjekteve të Varura të Siguruesve, për miratimin e hapjes dhe zhvendosjes së degëve dhe nëndegëve brenda vendit, siguruesi duhet të dorëzojnë kërkesë me shkrim në BQK së bashku me informatat e mëposhtme:

- formulari i aplikimit sipas shtojcës 5 të këtij manuali (Formulari aplikacioni për hapjen e degës ose zhvendosjes së degës/zyrës brenda Kosovës);
- vendimin e organit vendimmarrës për hapjen apo zhvendosjen e zyrës;
- përshkrimin e arsyeshmërisë së hapjes apo zhvendosjes të degës
- marrëveshjen/kontratën e qirasë në bazë të së cilës subjekti ka të drejtë të përdorë ambientet ku dega do të kryej veprimtari siguruese;
- adresën e saktë të degës së re;
- njoftimi me shkrim për plotësimin e kushteve teknike dhe të sigurisë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, për kryerjen e veprimtarisë siguruese. Në këtë njoftim duhet specifikuar hapat e ndërmarra lidhur me plotësimin e këtyre kushteve si dhe fotografitë që dëshmojnë një gjë të tillë;
- dëshminë e pagesë së tarifës;
- informacione tjera shtesë të cilat mund të konsiderohen si të duhura nga BQK-ja.

BQK-ja mund të kryej inspektimi në zyrat e siguruesve ku planifikohet të ushtrohet veprimtaria, para ose pas miratimit.

Pas shqyrtimit të kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës, BQK-ja vendos për miratimin apo refuzimin e kërkesës brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e pranimit të kërkesës së kompletuar.

BQK-ja ka të drejtë të pezullojë ushtrimin e veprimtarisë së zyrës, nëse ajo konstaton se kushtet teknike dhe të sigurisë për ushtrimin e veprimtarisë financiare nuk janë përmbushur.

4.8. Mbyllja e degëve dhe zyrave brenda vendit

Siguruesi para se të mbyllë një degë ose zyrë në Kosovë duhet të marrë miratim paraprak me shkrim nga BQK, siç përcaktohet me nenin 14 paragrafi 1 të Ligjit për Sigurimet.

Sipas Rregullores për Licencimin e Siguruesve dhe Degëve të Siguruesve të Jashtëm, siguruesi duhet t'i dërgojë BQK-së kërkesë për miratim të mbylljes së paku tridhjetë (30) ditë para mbylljes së planifikuar.

Kërkesa për mbyllje të degës ose zyrës duhet të përfshijë si më poshtë:

- identifikimin e degës/zyrës që do të mbyllet;
- datën e propozuar të mbylljes;
- raportin me arsyet e marrjes së vendimit për mbylljen e degës/zyrës ; dhe
- informatat statistikore apo të tjera që mbështesin mbylljen e degës.

Siguruesi që propozon mbylljen e një dege /zyrë, kërkohet që të shpallë njoftimin për klientët e degës ose zyrës në mënyrë të dukshme në lokalet e degës/zyrës së paku tridhjetë (30) ditë para datës së propozuar të mbylljes. Në njoftim duhet të theksohet data e propozuar e mbylljes dhe të identifikohet, se ku mund të shërbehen klientët pas datës së mbylljes ose të sigurohen numra telefonikë për klientët, që të mund të kontaktojnë dhe të përcaktojnë vendet e tilla alternative.

Brenda tridhjetë (30) ditësh kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së kompletuar, BQK-ja do të miratojë apo refuzojë kërkesën për mbylljen zyrës.

4.9. Hapja e degëve ose e subjekteve të varura jashtë vendit

Sipas nenit 14 paragrafi 2 të Ligjit për Sigurimet, një sigurues, përveç siguruesit të jashtëm, duhet të marrë miratimin paraprak me shkrim nga BQK-ja para se të themelojë ose hapë një degë në ndonjë juridiksion tjetër.

Sipas Rregullores për Hapjen dhe Mbylljen Brenda dhe Jashtë Kosovës të Degëve dhe Subjekteve të Varura të Siguruesve, siguruesit duhet të dorëzojnë kërkesë me shkrim në BQK për hapjen e një degë jashtë Republikës së Kosovës të shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- formulari i aplikimit sipas shtojcës 4 të këtij manuali (Formulari aplikacioni për hapjen e një dege/subjekti të varur jashtë Kosovës);
- vendimin e organit vendimmarrës të Siguruesit për miratimin e këtij zgjerimi jashtë Republikës së Kosovës;
- vendndodhjen dhe zonën e ushtrimit të veprimtarisë nga dega e propozuar;
- një kopje të rregullave dhe procedurave të degës së propozuar, ku të përcaktohen veprimtaritë që do të kryhen;
- biznes-planin për degën për tri (3) vitet e para të veprimtarisë;
- shumën e kapitalit që do të investohet jashtë vendit, si dhe pagesat ose shpenzimet për blerjen ose marrjen me qira të lokaleve dhe të pajisjeve të punës si dhe shpenzimet e tjera operative;

- informacionin për personin/at e propozuar si drejtues të degës, të shoqëruar me një përshkrim të shkurtër të kompetencave të tij;
- parashikimin e Siguruesit, të rezultatit financiar të saj pas realizimit të këtij zgjerimi, si dhe ndikimin e tij në gjendjen financiare të Siguruesit;
- strukturën organizative të degës së bashku me numrin e punonjësve të propozuar;
- emërtimin, e propozuar për t'u përdorur nga dega, që duhet të korrespondojë me emërtimin e Siguruesit dhe
- informata të tjera që mund të konsiderohen të nevojshme nga BQK-ja.

Për të hapur një subjekt të varur jashtë Republikës së Kosovës, siguruesi duhet të dorëzojë një kërkesë me shkrim në BQK të shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- dokumentacioni që kërkohet për themelimin e degës jashtë Republikës së Kosovës, të përshkruar me lartë në këtë pikë;
- plani i biznesit i subjektit të varur dhe parashikimi për ndikimin e zgjerimit të rrjetit në gjendjen financiare të siguruesit, për tre (3) vitet e para të veprimtarisë;
- informacion për bordin e drejtoreve dhe menaxherët e lartë të subjektit të varur;
- informacion për identitetin, vendqëndrimin/rezidencën ose selinë si dhe të dhënat tregtare të vitit të fundit për çdo person që do të zotërojë pjesëmarrje influencuese në subjektin e varur;
- veprimtaritë siguroese që subjekti i varur parashikon të kryej.

Brenda tridhjetë (30) ditësh kalendarike prej datës së pranimit të aplikacionit të kompletuar për degë ose subjekt të varur, BQK-ja duhet të miratojë ose të refuzojë kërkesën. BQK-ja jep miratimin paraprak për zgjerimin e Siguruesit jashtë Republikës së Kosovës përmes degës apo subjektit të varur vetëm pasi të jetë bindur pas shqyrtimit të dokumentacionit të pranuar në pajtueshmëri me paragrafët e lartëcekur.

Degët e Siguruesve që hapen jashtë territorit të Republikës së Kosovës mund të kryejnë vetëm ato veprimtari, për të cilat Siguruesi është i licencuar në Kosovë;

4.10. Auditori i jashtëm

Auditori i jashtëm i një siguruesi të licencuar nga BQK-ja për të operuar në Kosovë duhet të miratohet nga BQK-ja, sipas nenit 78 të Ligjit për Sigurimet. Çështjet që kanë të bëjnë me auditimin e jashtëm të siguruesve, rregullohen edhe me nenet 79, 80 dhe 81 të Ligjit për Sigurimet dhe Rregulloren për Auditimin e Jashtëm të Siguruesve, Ndërmjetësuesve të Sigurimeve, Trajtuesve të Dëmeve dhe Byrosë Kosovare të Sigurimit.

Siguruesi, së bashku me aplikacionin për miratim, duhet t'i sigurojë BQK-së:

- programin e auditimit të siguruesit;
- përshkrimin e shfrytëzimit të burimeve gjatë shërbimit të auditimit;
- letrën e angazhimit të auditorit të jashtëm ose kontratën e shërbimit të ofruar;

- dokumentin që vërteton përvojën e mjaftueshme të auditorit të jashtëm apo të stafit të tij i cili kryen auditimin në fushën e auditimit të sigurimeve; apo institucioneve të tjera financiare;
- vërtetimin e lëshuar nga KKRF-ja në lidhje me rezultatet e kontrollit të fundit të cilësisë për auditorin e jashtëm (në qoftë se KKRF-ja nuk lëshon një vërtetim të tillë, i njëjti nuk do të kërkohet nga BQK-ja);
- programi i auditimit dhe shfrytëzimi i burimeve gjatë shërbimit të auditimit, duhet të jetë i përshtatshëm në raport me karakterin dhe madhësinë e siguresit.

Aplikacionet për miratim të auditorit të jashtëm duhet të dorëzohen në BQK para datës 30 korrik të secilit vit. Punësimi i vazhdueshëm i auditorit të jashtëm të njëjtë është i kufizuar në 5 vite të njëpasnjëshme, ndërsa mund të rimarrë pjesë në auditimin e të njëjtit sigures pas mbarimit të afatit kohor prej të paktën dy (2) vite.

Bazuar në aplikacionin me shkrim, BQK-ja do të miratojë si auditor të jashtëm të një siguresi vetëm:

- një auditor të jashtëm të licencuar në Kosovë në pajtim me Ligjin për raportim financiar;
- një auditor të jashtëm që ka së paku 3 (tre) vjet eksperiencë në, fushën e auditimit të pasqyrave financiare të sigurueseve apo institucioneve të tjera financiare apo stafi pjesëmarrës i të cilit kryen auditimin të ketë një eksperiencë të tillë;
- kriteret tjera të përcaktuara me Rregulloren për Auditimin e Jashtëm të Siguruesve; ndërmjetësuesve të sigurimeve, trajtuesve të dëmeve dhe Byrore Kosovare të Sigurimeve;
- miratimi që i jepet auditorit të jashtëm është kufizuar për një sigures specifik dhe është i vlefshëm për një vit financiar;
- auditimi i siguruesve duhet të mbulojë të gjitha fushat e veprimtarisë së siguresit: portofolin e sigurimeve, vlerësimin e mjeteve dhe mjaftueshmërinë e tyre, provizionet teknike të cilat duhet të jenë të mjaftueshme për të mbuluar përgjegjësitë e nënshkruara dhe humbjet nga rreziqet që rrjedhin nga kontratat e sigurimit, provizionet teknike për primin e pafiturar, provizionet për rezervat për bruto dëmet, siç është përshkruar në nenin 67 të Ligjit për Sigurimet, si dhe të japë opinionin e tij lidhur me mjaftueshmërinë apo pa mjaftueshmërinë e tyre të kalkuluar nga aktuari i siguresit.

Miratimi që i jepet auditorit të jashtëm është i kufizuar për një sigures specifik dhe është i vlefshëm për një vit financiar.

Brenda tridhjetë (30) ditësh kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së kompletuar, BQK-ja do të miratojë apo refuzojë kërkesën për auditor të jashtëm.

4.11. Transferimi i portofolit të sigurimit

Portofoli i sigurimit mund të transferohet te siguresi pranues, vetëm pasi siguresi pranues ka marrë miratimin e BQK-së për të pranuar portofolin e sigurimeve, siç edhe përcaktohet me nenin 36 të Ligjit për Sigurimet. Siguresi i cili i transferon portofolin e sigurimit, quhet sigures transferues, kurse siguresi tek i cili transferohen kontratat e sigurimit, quhet sigures pranues. *Transferimi i portofolit të sigurimeve rregullohet edhe me nenin 36, 37 dhe nenin 38 të Ligjit për Sigurimet.*

Siguruesi me miratim të BQK-së, mund të transferojë nëpërmjet një marrëveshje te një sigurues tjetër, të gjitha ose një pjesë të portofolit të saj të sigurimit, të nënshkruara në një apo disa klasa të caktuara të sigurimit me të gjitha detyrimet dhe të drejtat.

Siguruesi mund të transferojë portofolin e saj të sigurimit te:

- siguruesi me seli qendrore në Republikën e Kosovës, i licencuar nga BQK-ja;
- dega e një siguruesi të jashtëm, e licencuar nga BQK-ja.

Përveç portofolit të transferuar, siguruesi transferues transferon edhe aktivet në mbulim të provizioneve teknike dhe matematike, të barabarta me provizionet teknike dhe matematike të përlllogaritura, për të mbuluar përgjegjësitë e portofolit të sigurimit që do të transferohen.

Kërkesa për miratimin e transferimit të portofolit të sigurimit bëhet me shkrim nga siguruesi transferues dhe përmban:

- miratimin e transferimit nga asambleja e përgjithshme e aksionarëve dhe bordit të drejtorëve të siguruesit transferues;
- miratimin e transferimit të siguruesit pranues nga asambleja e përgjithshme e aksionarëve dhe bordi i drejtorëve të tij;
- listën e kontratave të sigurimit, të ndara sipas klasave të sigurimit, së bashku me kushtet e veçanta dhe të përgjithshme të tyre, që kërkohen të transferohen si dhe llogaritjet e provizioneve teknike dhe matematike për klasat e sigurimit në fjalë;
- aktivet në mbulim të provizioneve teknike dhe matematike, përfshirë këtu vlerën e tyre përkatëse, si dhe të gjitha të dhënat që mund të përdoren për verifikimin e llogaritjes së këtyre vlerave;
- planin e ndryshuar të biznesit që nevojitet për transferimin e portofolit të sigurimit, të siguruesit pranues;
- kontratën e transferimit të portofolit të sigurimit;
- afatin kohor për transferimin e portofolit;
- Në rastin kur siguruesi pranues është degë e një siguruesi të jashtëm, kërkohet miratim me shkrim nga autoriteti mbikëqyrës i vendit amë.

Pas shqyrtimit të kërkesës së kompletuar, BQK brenda 30 diteve vendos për miratimin apo refuzimin e saj.

- BQK-ja refuzon kërkesën për transferimin e portofolit të sigurimit nëse: siguruesi pranues nuk është i licencuar për ushtrimin e veprimtarisë në klasat e sigurimeve, që i përkasin portofolit të sigurimit që transferohet;
- vlera e aktiveve në mbulim të provizioneve teknike dhe matematike të siguruesit pranues është më e ulët sesa vlera e provizioneve, që duhet të krijoheshin kundrejt portofolit të sigurimit, që do të transferohet.

- siguruesi pranues nuk plotëson kërkesat ligjore për klasat e sigurimeve, që i përkasin portofolit që transferohet ose në qoftë se me pranimin e portofolit veprimtaria e siguruesit pranues në lidhje me rregullat e menaxhimit të rrezikut mund të përkeqësohet.

Në rastin kur siguruesi pranues është degë e një siguruesi të jashtëm, BQK-ja merr vendim për miratim, vetëm nëse autoriteti mbikëqyrës i vendit amë, jep miratimin me shkrim.

Gjithashtu për qëllime të shqyrtimit të kërkesave për transferimin e portofolit, Departamenti i Licencimit dhe Standardizimit kërkon edhe opinionin e Departamentit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve për gjendjen financiare të siguruesit transferues dhe atij pranues.

Për transferimin e portofolit të sigurimit nuk kërkohet miratimi i të siguruarve. Siguruesi pranues njofton të siguruarit për transferimin e portofolit të sigurimit, me anë të mjeteve publike të komunikimit, në territorin ku ndodhet rreziku i mbuluar nga kontratat e sigurimit të transferuara, brenda dhjetë (10) ditëve kalendarike nga data e miratimit të BQK-së për transferim të portofolit.

4.12. Delegimi i funksioneve

Delegimi i funksioneve të siguruesve, është rregulluar me neni 39 të Ligjit për Sigurimet dhe nenin 3 të Rregullores për Delegimin e Funksioneve të Siguruesve, të cilat përcaktojnë se siguruesi mund të delegojë funksionet që lejohet të delegohen, vetëm pasi të ketë marrë miratimin paraprak me shkrim nga BQK-ja. Për më tepër theksojnë se funksionet e siguruesit mund të delegohen, vetëm nëpërmjet një kontrate të shkruar, në bazë të cilës siguruesi transferon një pjesë të funksioneve të saj, te një person tjetër. *Çështja e delegimit të funksioneve më tutje rregullohet edhe me nenin 40 të Ligjit për Sigurimet dhe Rregulloren për Delegimin e Funksioneve të Siguruesve.*

Funksionet të cilat mund të delegohen nga siguruesit janë si në vijim:

- trajtimi dhe vlerësimi i dëmeve, të licencuara nga BQK-ja;
- shërbimet aktuariale, të licencuara nga BQK-ja;
- shërbimet e promovimit dhe marketingut;
- shërbimet e teknologjisë informative;
- mbajtjen e kontabilitetit;
- menaxhimin e risigurimeve dhe marrëdhëniet me siguruesit e jashtëm.

Funksionet e lartpërmendura mund të delegohen, vetëm nëpërmjet një kontrate të shkruar, ndërmjet siguruesit dhe pranuesit të funksioneve të deleguara, e cila duhet të përmbajë elementet si në vijim:

- të drejtat dhe detyrimet e palëve;
- një dispozitë e cila përcakton se siguruesi që delegon përgjegjësinë është përgjegjës për funksionet e transferuara tek personi tjetër dhe, në asnjë rast, nuk shmang përgjegjësitë e organeve drejtuese të siguruesit;
- një dispozitë e cila përcakton se pranuesi i funksioneve të deleguara është i obliguar t'i ofroj siguruesit informacionet e kërkuara sipas nenit 6 paragrafi c) të Rregullores për Delegimin e Funksioneve të Siguruesve;

- angazhimin e personit të deleguar për të kryer veprimtarinë e tij në përputhje me legjislacionin në fuqi, kërkesat rregullatore si dhe politikat e miratuara nga siguruesi dhe për të bashkëpunuar me BQK-në për sa i përket funksioneve të deleguara;
- dispozitë që përcakton se personi pranues i funksioneve të deleguara, do t'i nënshtrohet mbikëqyrjes nga ana e BQK-së;
- detyrimin e personit të deleguar për të informuar menjëherë siguruesin për çdo fakt që mund të ketë një ndikim të rëndësishëm në aftësinë e tij për të kryer në mënyrë efikase dhe efektive veprimtarinë e tij sipas kërkesave ligjore në fuqi;
- një periudhë njoftimi për përfundimin e kontratës nga ana e personit të deleguar, e cila është e mjaftueshme për siguruesin të gjejë një zgjidhje alternative;
- të drejtën e siguruesit për t'u informuar në lidhje me mbarëvajtjen e funksioneve të deleguara nga personi i deleguar, si dhe të drejtën e siguruesit për të hartuar dhe miratuar udhëzime të përgjithshme apo të veçanta në lidhje me kryerjen e funksioneve të deleguara;
- ruajtjen e konfidencialitetit nga ana e personit të deleguar, të të dhënave që lidhen me siguruesin dhe me të siguruarin;
- të drejtën e siguruesit për t'u tërhequr nga kontrata, nëse kjo e fundit kërkohet nga BQK-ja për shkaqe të mosrespektimit të kritereve ligjore.

Përveç asaj që u tha më lartë kontrata për delegim të funksioneve, duhet të përmbajë një dispozitë, e cila përcakton se siguruesi që delegon përgjegjësinë është përgjegjës për funksionet e transferuara te personi tjetër. Kontrata për delegimin e funksioneve gjithashtu duhet të përcaktojë se personi pranues i funksioneve të deleguara, do t'i nënshtrohet mbikëqyrjes nga ana e BQK-së.

Siguruesi duhet të sigurohet se delegimi i funksioneve:

- nuk cenon rezultatet financiare dhe stabilitetin e siguruesit si dhe vazhdimësinë e veprimtarive të tij;
- nuk cenon cilësinë e menaxhimit dhe vendim marrjes së siguruesit;
- nuk cenon aftësinë e siguruesit për t'ju ofruar të siguruarve një shërbim të vazhdueshëm;
- nuk krijon një rritje të pajustificuar të rreziqeve operacionale.

Siguruesi përpara përzgjedhjes së pranuesit të funksioneve të deleguara, duhet:

- të sigurohet se pranuesi i funksioneve të deleguara është i aftë dhe i përshtatshëm për t'i kryer funksionet e deleguara;
- të kryej një analizë të detajuar të aftësisë dhe kompetencës profesionale të pranuesit të funksioneve të deleguara;
- të sigurohet që pranuesi i funksioneve të deleguara ka marrë të gjitha masat e nevojshme për shmangien e konfliktit të interesit;

Për miratimin e delegimit të funksioneve, siguruesit duhet të paraqesin kërkesë me shkrim në BQK. Kërkesa për miratim të funksioneve të deleguara duhet të shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

- vendimin e bordit të drejtoreve të siguruesit përmes të cilit është vendosur delegimi i funksioneve;
- përshkrimin e funksioneve që siguruesi kërkon të delegojë, si dhe kushtet që duhet të përmbushë pranuesi potencial i funksioneve të deleguara, si dhe kohëzgjatjen e delegimit të funksioneve;
- të dhëna mbi pranuesin potencial të funksioneve të deleguara, si: emrin, certifikatën e regjistrimit të biznesit, kualifikimet, raportet financiare për tri vitet e fundit (nëse janë të aplikueshme sipas legjislacionit në fuqi për raportim financiar), si dhe të dhëna të tjera në rastet e personave potencial të deleguar nga një vend i huaj: adresën, numrin e telefonit, numrin e faksit, adresën e e-mailit, faqen zyrtare, emrin, mbiemrin dhe detaje të kontaktimit të personit të autorizuar për përfaqësim të pranuesit të funksioneve të deleguara; në rastin kur pranuesi i funksioneve të deleguara është person i jashtëm, përveç të dhënave të lartpërmendura në këtë nënparagraf, BQK-ja, sipas vlerësimit të saj, mund të kërkojë edhe të dhëna të tjera.
- rezultatet e analizave dhe vlerësimeve të kryera nga siguruesi sipas përcaktimeve të nenit 3, paragrafi 5, nënparagrafi b) të Rregullores për Delegimin e Funksioneve të Siguruesve;
- drafti i kontratës me përmbajtje sipas përcaktimeve të nenit 5 të Rregullores për delegimin e funksioneve të siguruesve;
- dokumente që vërtetojnë përvojën e pranuesit të funksionit të deleguar për veprimtaritë e njëjta me funksionin e deleguar nga siguruesi (nëse ka);
- dokumentacion që vërteton çdo përvojë tjetër të pranuesit të funksionit të deleguar.

BQK-ja, brenda afatit prej 30 ditë kalendarike nga pranimi i kërkesës, miraton ose refuzon kërkesën për miratim të funksioneve të deleguara. Gjatë shqyrtimit të kërkesës, BQK-ja mund të kërkojë nga siguruesi, dokumentacion dhe informata shtesë. Në raste të tilla, afati prej 30 ditëve fillon të rrjedh nga momenti kur dokumentacioni dhe informatat shtesë pranohen në BQK.

BQK-ja mund të refuzojë apo tërheq miratimin e delegimit të funksioneve nëse:

- rrezikohen interesat e të siguruarve;
- vështirësohet ose bëhet e pamundur mbikëqyrja në lidhje me funksionet e deleguara;
- pranuesi i funksioneve të deleguara, nuk ka kompetencë për funksionet e deleguara.

BQK-ja mund ta tërheq miratimin e funksioneve të deleguara nëse vlerëson se ushtrimi më tutje i funksioneve të deleguara nga pranuesi i tyre, rrezikon interesat e policëmbajtësve, vështirësohet mbikëqyrja nga ana e BQK-së dhe pranuesi i funksioneve të deleguara nuk ka kompetence profesionale për të ushtruar funksionin e deleguar.

4.13. Bashkimet dhe përvetësimet

Asnjë sigurues nuk mund të bashkohet me ndonjë sigurues tjetër ose të përvetësojë, qoftë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi, aktiven apo të pranojë pasivën e ndonjë siguruesi tjetër, pa miratimin paraprak të BQK-së, siç edhe përcaktohet me nenin 41 të Ligjit për Sigurimet. *Çështjet e bashkimeve dhe përvetësimeve të siguruesve më*

tutje rregullohen me Rregulloren për Bashkimet dhe Përvetësimet e Siguruesve, e cila edhe përcakton informatat të cilat kërkohen para se një sigurues të riorganizohet nëpërmjet bashkimit me ndonjë institucion tjetër financiar apo ndonjë kompani tjetër.

Nëse qëllimi i aplikuesit për bashkim është krijimi i një siguruesit të ri, BQK-ja do ta trajtoj atë bashkim si aplikacion për licence të re ashtu siç përcaktohet me Ligjin për Sigurimet dhe Rregulloren për Licencimin e Siguruesve dhe Degëve të Siguruesve të Jashtëm dhe kapitullin 2 dhe 3 të këtij manuali.

Kërkesa për miratim për siguruesin e riorganizuar nëpërmjet bashkimit duhet të mbështetet nga dokumentacioni në vijim:

- vendimin e asambleve të aksionarëve siguruesve të përfshirë në operacion për miratimin e riorganizimit të tyre nëpërmjet bashkimit;
- draft-marrëveshja dhe raporti i detajuar i procesit të bashkimit, të nënshkruar nga përfaqësuesit ligjor të siguruesve të përfshira në procesin e bashkimit. Draft-marrëveshja dhe raporti përpilohen me shkrim dhe në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- raporti i ekspertëve të pavarur të licencuar në fusha të ndryshme, për të vlerësuar kushtet e draft-marrëveshjes së bashkimit;
- draft-statuti i siguruesit pas realizimit të procesit të bashkimit;
- planet strategjike dhe operative për të kryer bashkimin, ku përfshihen analizat e nevojshme të përvetësimit dhe parashikimet e pasqyrave financiare për siguruesin e bashkuar;
- në rast të ndryshimit të drejtorëve dhe menaxherëve të lartë të siguruesit të bashkuar, duhet të paraqitet dokumentacioni në përputhje me kërkesat për drejtorët, siç është përcaktuar në Ligjin për Sigurimet dhe Rregulloren për Licencimin e Siguruesve dhe Degëve të Siguruesve të Jashtëm;
- struktura e aksionarëve të siguruesit të bashkuar.

Afatet e cekura në fillim të këtij kapitulli nuk aplikohen për kërkesat e siguruesve për bashkimet dhe përvetësimet. Për këtë qëllim, BQK-ja, do të diskutojë me siguruesin afatin kohor që do të jetë i nevojshëm për miratimet paraprake duke lejuar siguruesin, që të fillojë diskutimet me palën tjetër apo palët e tjera të përfshira pa angazhimin e BQK-së. Mirëpo afatet për këto kërkesa nuk mund të kalojnë afatet e parapara në kapitullin 2 të këtij manuali.

BQK miraton procesin e bashkimit nëse:

- bashkimi nuk rrezikon gjendjen financiare të siguruesit të bashkuar;
- siguruesi ka sistem të organizimit, menaxhimit, vendimmarrjes dhe teknologjisë informative e cila mundëson integrimin e plotë të siguruesit të bashkuar në atë mënyrë që të mos e rrezikojë funksionimin e tij;
- bashkimi është ekonomikisht i arsyeshëm.

Është përgjegjësi e siguruesit për të marrë miratime nga autoritetet e tjera që mund të jenë të nevojshme para se transaksioni të ketë përfunduar.

4.14. Përvetësimet e interesit të kapitalit nga siguruesit në institucionet financiare

Përvetësimi i interesit të kapitalit nga siguruesit në institucionet financiare nuk mund të bëhet pa miratim të BQK-së. Neni 41 paragrafi 2 i Ligjit për Sigurimet thekson se kërkesat për t'u bashkuar dhe përvetësuar aktivën apo për të pranuar pasivën e siguruesit, bëhen në formën e përcaktuar nga BQK-ja dhe shoqërohen nga informacionet të cilat kërkohen nga BQK-ja.

Sipas nenit 4 të Rregullores për Bashkimet dhe Përvetësimet e Siguruesve, varësisht nga natyra dhe niveli (sa i përket përqindjes së kapitalit që siguruesi planifikon të përfshijë) dhe madhësia e transaksionit ndaj madhësisë së siguruesit përvetësues, BQK-ja do të përcaktojë se cilat informata shtesë janë të nevojshme para se të mund të shqyrtohet kërkesa.

Në parim, dokumentacioni i kërkuar për shqyrtimin e këtyre kërkesave është si në vijim:

- vendimet përkatëse të asambleve të aksionarëve të siguruesit përvetësues dhe institucionit financiar të përfshirë në veprim për miratimin e riorganizimit të tyre nëpërmjet përvetësimit;
- marrëveshja/draft dhe raporti i detajuar i procesit të përvetësimit, të nënshkruar nga përfaqësuesit ligjor të siguruesve të përfshirë në procesin e përvetësimit. Marrëveshja/draft dhe raporti përpilohen me shkrim dhe në përshtatje me legjislacionin në fuqi;
- raporti i ekspertëve të pavarur të licencuar në fusha të ndryshme, për të vlerësuar kushtet e draft marrëveshjes së përvetësimit;
- draft statuti i siguruesit përvetësues pas realizimit, të procesit të përvetësimit;
- planet strategjike dhe operative për të kryer përvetësimin, ku përfshihen analizat e nevojshme të përvetësimit dhe parashikimet e pasqyrave financiare për siguruesin përvetësues;
- në rast të ndryshimit të drejtorëve dhe menaxherëve të lartë të siguruesit përvetësues, duhet të paraqitet dokumentacioni në përputhje me kërkesat për drejtorët dhe menaxherët e lartë siç është e përcaktuar me Ligjin për Sigurimet, Rregulloren për Licencimin e Siguruesve dhe Degëve të Siguruesve të Jashtëm si dhe më këtë manual;
- struktura e re e aksionarëve të siguruesit përvetësues.

BQK-ja shqyrton aplikacionin nga aspekti i ndikimit në kapitalin e siguruesit përvetësues, kapacitetin e menaxhmentit të siguruesit përvetësues dhe ndonjë ndryshim të parashikuar në bordin e drejtorëve dhe menaxhmentin e lartë të siguruesit përvetësues. BQK gjatë shqyrtimit të këtyre kërkesave do të vlerësojë edhe performancën financiare nga ekzaminimi i fundit i bërë në vend të siguruesit përvetësues dhe siguruesit të përvetësuar si dhe raportet e fundit të auditorit të jashtëm të tyre.

Afatet e cekura në fillim të këtij kapitulli nuk aplikohen për kërkesat e siguruesve për bashkimet dhe përvetësimet. Për këtë qëllim, BQK-ja, do të diskutojë me siguruesin përvetësues afatin kohor që do të jetë i nevojshëm për miratim duke lejuar siguruesin përvetësues që të fillojë diskutimet me palën tjetër apo palët e tjera të përfshira pa angazhimin e BQK-së. Mirëpo i gjithë procesi nuk mund të zgjas më shumë se afatet për licencimin e siguruesve të përcaktuara me Ligjin për Sigurimet dhe Rregulloren për Licencimin e Siguruesve dhe Degëve të Siguruesve të Jashtëm.

BQK miraton procesin e përvetësimit nëse sipas vlerësimit të saj:

- përvetësimi nuk rrezikon gjendjen financiare të siguruesit përvetësues;
- siguruesi e ka sistem të organizimit, menaxhimit, vendimmarrjes dhe teknologjisë informative e cila mundëson integrimin e plotë të institucionit të përvetësuar në atë mënyrë që të mos e rrezikojë funksionimin e tij;
- përvetësimi është ekonomikisht i arsyeshëm për siguruesin përvetësues;
- përvetësimi i mbron në mënyrë adekuate të drejtat e policëmbajtësve dhe të siguruarve.

Kur institucioni në të cilin investohet është gjithashtu i rregulluar me Ligjin për Sigurimet, BQK-ja shqyrton edhe përshtatshmërinë e siguruesit investues si aksionar i institucionit në të cilin investohet në pajtueshmëri me nenet relevante të Ligjit për Sigurimet.

4.15. Hapja e zyrave përfaqësuese

Asnjë sigurues i jashtëm nuk mund të themelojë dhe operojë me një zyrë përfaqësuese në Kosovë pa leje paraprake nga BQK-ja, siç edhe përcaktohet me nenin 13 të Ligjit për Sigurimet. BQK-ja mund të japë leje për një zyrë përfaqësuese në Kosovë, me kusht që të sigurohet se siguruesi i jashtëm do t'i kufizojë veprimtaritë e zyrës përfaqësuese në ofrimin e informatave, veprimtarive ndërlidhëse, studimit të tregjeve dhe mundësive për investim, dhe se siguruesi i jashtëm nuk do të angazhohet në veprimtari të sigurimit në Kosovë nëpërmjet zyrës përfaqësuese. *Çështja e zyrave përfaqësuese më tutje rregullohet me Rregulloren për Hapjen e Zyrave Përfaqësuese Brenda Republikës së Kosovës nga Siguruesit e Jashtëm.*

Kërkesa e siguruesit të jashtëm për hapje të zyrës përfaqësuese në Republikën e Kosovës duhet të mbështet me dokumentacionin e mëposhtëm:

- vendimin e organit kompetent të siguruesit të jashtëm për hapjen e zyrës përfaqësuese;
- qëllimin e hapjes së saj;
- kohëzgjatjen e parashikuar të veprimtarisë së zyrës përfaqësuese, adresën dhe numrin e telefonit;
- emrat e personave të propozuar si drejtorë të zyrës së përfaqësimit të shoqëruar me curriculum vitae të tyre (arsimimin, profesionin, eksperiencën etj.);
- numrin e parashikuar të punonjësve të zyrës;
- dokumentin e regjistrimit të zyrës përfaqësuese në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe ndonjë miratim nëse kërkohet nga autoriteti mbikëqyrës i vendit përkatës për hapjen e zyrës përfaqësuese.

Zyra përfaqësuese e një siguruesi të jashtëm duhet të regjistrohet dhe të përdorë të njëjtin emër me atë të siguruesit amë, duke shtuar fjalët “Zyrë përfaqësimi”.

BQK-ja shqyrton kërkesën e siguruesit të jashtëm bazuar në kushtet dhe afatet e përcaktuara me legjislacionin përkatës dhe brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh kalendarike prej datës së pranimit të aplikacionit për zyrë përfaqësimi, BQK-ja miraton ose refuzon kërkesën përcakton kushtet dhe afatet për një zyrë të tillë.

4.16. Transaksionet që kërkojnë vetëm njoftim të BQK-së

Transaksionet të cilat realizohen pas licencimit të siguruesit dhe fillimit të operacioneve të tij e që për të cilat nuk kërkohet miratim paraprak nga ana e BQK-së mirëpo për të cilat kërkohet njoftimi i BQK-së janë si në vijim:

- dorëheqja e drejtorëve dhe menaxherëve të lartë;
- riemërimi i drejtorëve dhe menaxherëve të lartë;
- ndryshimet në strukturën organizative, nëse ky ndryshim nuk reflektohet në statutin e siguruesit;
- ndryshimet në pronësinë e aksionarëve që posedojnë më pak se pesë përqind (5%) të kapitalit;
- përvetësimi i aksioneve nga pesë përqind (5%) deri në dhjetë përqind (10%);
- mbyllja e zyrave përfaqësuese të siguruesve të jashtëm.

Siguruesi duhet të njoftojë BQK-në brenda tridhjetë (30) ditëve për ndryshimet e ndodhura të specifikuar më lartë dhe pas pranimit të njoftimit BQK-ja informon siguruesin për pranimin e njoftimit.

5. SHTOJCAT E MANUALIT

- I – Procesi i Licencimit të Siguruesve;
- II – Kriteret e Licencimit të Siguruesve;
- III – Alternativat ndaj Licencimit të Siguruesve;
- IV – Siguruesit e Jashtëm (Huaj);


- 1 – Lista Kontrolluese për Plotësimin dhe Dorëzimin e Aplikacionit për Licencim të Siguruesve;
- 2 – Formular Aplikimi për Licencë të Siguruesve;
- 3 – Formular Aplikimi për Hapjen dhe Zhvendosjen e Degëve/Zyrave Brenda Kosovës;
- 4 – Formular Aplikimi për Hapjen e Degëve/Subjekteve të Varura Jashtë Kosovës;

- A – CV Individuale;
- B – Raporti i Aksionarit Kompani (RK);
- C – CV e Aksionarit Individual;
- D – Format e Projeksioneve Financiare.

6. HYRJA NË FUQI

Ky Manual hynë në fuqi në datën e miratimit.

SHTOJCA 1 – PROCESI I LICENCIMIT SI SIGURUES



Kur jeni të gatshëm të filloni këtë proces, ju lutem kontaktoni Departamentin e Licencimit dhe Standardizimit për të caktuar takim informues para aplikimit në.

+381 (0) 38 / 222 055 Licencimi@bqk-kos.org

Rr. Garibaldi nr. 33, Prishtinë, Republika e Kosovës



SHTOJCA II – KRITERET E BQK-së PËR LICENCIM TË SIGURUESVE

Kriteret e licencimit sigurues në Republikën e Kosovës janë përcaktuar në nenin 11, paragrafi 3,4 dhe 5 të Ligjit nr. 05/L-045 Sigurimet. Sipas këtyre dispozitave, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) miraton një licencë siguruese kur të plotësohen kushtet e mëposhtme:

1. Nëse plani i biznesit bazohet në analiza të sakta dhe në supozime të arsyeshme;
2. Struktura organizative e siguruesit së propozuar dhe degëve të tij do t'i lejojë BQK-së të ushtrojë mbikëqyrje efektive dhe të konsoliduar;
3. Primet e llogaritura dhe provizionet teknike ose matematike janë të mjaftueshme për mbulimin e përgjegjësive të siguruesit;
4. Siguruesi i propozuar do të veprojë në pajtueshmëri me të gjitha dispozitat e Ligjit nr. 05/L-045 Sigurimet;
5. Kualifikimet, përvoja dhe integriteti i drejtorëve apo menaxherëve të saj të lartë janë të përshtatshëm për planin e biznesit të siguruesit të propozuar dhe aktivitetëve të sigurimit;
6. Aksionarët kryesorë, drejtorët dhe menaxherët e lartë të siguruesit të propozuar janë të përshtatshëm dhe të duhur, siç përcaktohet me nenin 24 të Ligjit nr. 05/L-045 Sigurimet dhe përcaktimeve tjera nga BQK-ja; dhe
7. Struktura e pronësisë së siguruesit, nuk do të pengoj mbikëqyrjen efektive prej BQK-së.

Në rastet kur kemi të bëjmë me aplikacione për licencim si subjekt i varur apo degë e siguruesit të jashtëm, subjektet aplikuese duhet të plotësojnë edhe kriteret e mëposhtme:

1. Siguruesi i jashtëm është i licencuar për t'u angazhuar në veprimtarinë e sigurimit në juridiksionin ku gjendet drejtoria e saj qendrore;
2. Autoriteti mbikëqyrës përgjegjës ku ka selinë qendrore siguruesi i jashtëm, ka dhënë pëlqimin e tij me shkrim për dhënien e licencës së këtyre; dhe
3. BQK-ja vlerëson se siguruesi i jashtëm mbikëqyret në mënyrë adekuate në bazë të konsoliduar globale nga autoriteti mbikëqyrës përgjegjës në shtetin amë. Autoriteti mbikëqyrës përgjegjës nga shteti amë, duhet ta pranojë me shkrim se është në dijeni të dhënies së licencës së re dhe pajtohet që t'i ofrojë informata BQK-së me kërkesë të saj.

Dhe, në rast të miratimit paraprak të një kërkesë për licencë, BQK-ja përcakton të gjitha kushtet për siguruesit të cilit i jepet licenca për fillimin e operacioneve të saj. Kushtet e këtyra mund të përfshijnë:

1. Pagesën e kapitalit fillestar që aksionarët duhet të bëjnë për siguruesin;
2. Punësimin dhe trajnimin e personelit të siguruesit;
3. Blerjen e pajisjeve operative dhe përcaktimin e sistemeve operative;
4. Marrjen me qira, blerjen ose zotërimin e lokaleve të siguruesit;
5. Primet e llogaritura dhe provizionet teknike ose matematike janë të mjaftueshme për mbulimin e përgjegjësive të siguruesit;
6. Draft-kontratat e sigurimit sipas klasave ku siguruesi kërkon të licencohet;
7. Angazhimin e një auditori të jashtëm dhe aktuari në përputhje me Ligjin për Sigurimet;
8. Çdo kusht tjetër që BQK-ja e konsideron të përshtatshëm.

Mirëpo, BQK-ja refuzon një licencë, nëse sipas gjykimit të saj të arsyetuar, lëshimi i një licence të kësaj lloji do të:

1. Vinte në rrezik qëndrueshmërinë financiare të siguruesit të propozuar ose të industrisë së sigurimeve në përgjithësi;
2. Rrezikonte interesat e policëmbajtesve të siguruesit të propozuar, dhe

Nëse brenda një (1) viti një siguruesi nuk vepron në përputhje me kushtet për marrjen e licencës për fillimin e veprimtarisë, miratimi paraprak i kërkesës do të revokohet.



SHTOJCA III - ALTERNATIVAT NDAJ LICENCIMIT TË SIGURUESVE

Në varësi të planit të biznesit ose aktiviteteve që të interesuarit dëshirojnë të ndërmarrin, themelimi i një siguruesi nuk është i vetmi option ose gjithmonë optioni më i përshtatshëm. Ekzistojnë dy alternativa tjera siç janë ri-siguruesit apo edhe ndërmjetësuesit në sigurime, që u lejonet të ofrojnë disa nga shërbimet që ofrojnë siguruesit, me kosto më të ulët se themelimi i një siguruesi.

Ushtrimi i aktiviteteve të lejuara për institucionet financiare pa miratim (licencim) paraparak nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës është vepër penale.

Risiguruesit

Risigurimi është sigurim që një sigurues blen nga nga një ose më shumë sigurues tjerë ("risiguruesi") direkt ose nëpërmjet një ndërmjetësuesi. Risigurimi konsiderohet si një mjet i menazhimit të rrezikut pasi që cedon rreziqet e caktuara nga një sigurues te një risigurues. Siguruesi dhe risiguruesi lidhin një marrëveshje risigurimi, e cila përcakton kushtet mbi të cilat risiguruesi do të paguajë një pjesë të dëmeve të shkaktuara.

Risiguruesi mund të jetë një sigurues i specializuar për risigurim, i cili merr përsipër vetëm biznesin e risigurimit.

Kriteret për licencimin sigurues dhe procedura e licencimit, të detajizuara në Manualin për Licencimin e Siguruesve, zbatohen përshtatshëmrisht edhe për licencimin risiguruesve. Me rastin e licencimit, risiguruesit kanë të drejtë të ofrojnë vetëm aktivitete të risigurimit.

Ndërmjetësuesit

Përderisa veprimtaria e sigurimit është veprimtari përmes së cilës siguruesi merr përsipër rreziqe të caktuara, përkundërt pagesës së primit, që me rastin e ndodhjes së ngjarjes së siguruar t'i paguajë të siguruarit, përfituesit apo palës së tretë dëmshpërblimin, veprimtaria e ndërmjetësimit në sigurime është veprimtaria e prezantimit, propozimit dhe kryerjes së aktiviteteve të tjera përgatitore, deri në nënshkrimin e kontratës së sigurimit, si dhe dhënien e asistencës gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës, veçanërisht në rast dëmi.

Ndërmjetësuesit mund të përdorin agentët si kanale të ofrimit të produkteve të sigurimit si në vijim:

- Agentët nuk janë të punësuar të kompanisë por janë të angazhuar sipas marrëveshjes së ndërmjetësimit me një ose më shumë sigurues (po jo për produkte të njëjta). Për tu licencuar agentët duhet të regjistrohen si Biznese Individuale B.I.

- Kompanitë e agjentëve – është person juridik i licencuar nga BQK-ja dhe të kontraktuar nga një ose më shumë sigurues (po jo për produkte të njëjta), që të zhvillojë aktivitetet të ndërmjetësimit në sigurime. Për tu licencuar si kompani e agjentëve duhet të regjistrohen si si biznes SH.P.K. apo SH.A.
- Brokerët individual – nuk janë të punësuar të kompanisë por janë të angazhuar sipas marrëveshjes së ndërmjetësimit me një ose më shumë sigurues. Për licencim në BQK, brokerët individual duhet të regjistrohen si biznese individuale;
- Kompanitë e brokerimit – është person juridik i licencuar nga BQK-ja dhe e kontraktuar nga një ose më shumë sigurues, të zhvillojë aktivitetet të ndërmjetësimit në sigurime. Për tu licencuar si kompani e agjentëve duhet regjistrim si biznes SH.P.K. apo SH.A.

Dallimi në mes të agjentëve dhe brokerëve është se agjentet e sigurimeve dhe kompanitë e agjenteve kryejnë veprimtari të ndërmjetësimit në sigurime në llogari të siguruesve, ndërsa brokeret dhe kompanitë e brokerimit kryejnë veprimtari të ndërmjetësimit në sigurime në llogari të te siguruarve.

Me rastin e aplikimit për licencim, aplikuesit duhet të specifikojnë saktë cilën formë organizmit të ndërmjetësimit planifikojnë të themelojnë, pasi që procesi i aplikimit dhe kriteret e licencimit të BQK-së për ndërmjetësues të organizuar në forma të ndryshme dallojnë mes vete. Procesit i licencimit është e sqaruar në Manualin e Licencimit të Ndërmjetësuesve.



SHTOJCA IV – SIGURUESIT E JASHTËM (HUAJ)

Siguruesi i jashtëm është personi juridik që është i organizuar, ka selinë e vet dhe posedon licencë për tu angazhuar në veprimtari të sigurimeve në ndonjë juridiksion tjetër përveç Kosovës. Siguruesit e jashtëm mund të operojnë në Kosovë si subjekte të varura filial apo degë.

Tiparet dalluese

Tiparet dalluese në mes të filialeve dhe degëve të siguruesve të jashtë janë të natyrave të ndryshme, qoftë nga aspekti i organizimit apo nga aspekti i mbikëqyrjes. Fillimisht, filial nënkupton një subjekt të varur të siguruesit të huaj, që është nën kontroll të përbashkët me këtë sigurues, ndërsa degë e siguruesit të jashtëm nënkupton një subjekt ligjërish të varur të siguruesit të jashtëm i pa themeluar me vete, nëpërmjet të cilës siguruesi i jashtëm angazhohet në veprimtari siguruese në Republikën e Kosovë.

Filiali i siguruesit të jashtëm i nënshtrohet të gjitha kërkesave ligjore të përcaktuara me Ligji nr. 05/L-045 për Sigurimet në mënyrë të njëjtë sikurse siguruesit vendor. Për dallim nga filialet, degët e siguruesve të jashtëm nuk iu nënshtrohen kërkesave ligjore në vijim:

- Kriteret për anëtarët e bordit të drejtorëve si dhe ndryshimet në anëtar të bordit të drejtorëve nuk aplikohet për degët siguruesve të jashtëm. Degës së siguruesit të jashtëm nuk do t'i kërkohej të themelojë Bord në Kosovë.
- Kërkesat e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) për themelimin e komiteteve nuk zbatohen për degët e siguruesve të jashtëm për aq kohë sa kërkesat e krahasueshme dhe të pranueshme për BQK-në zbatohen me ligj sipas të cilit siguruesi i jashtëm është licencuar në juridiksionin e tij amë;
- Miratimi i aksionarëve kryesor nuk kërkohej për degët e siguruesve të jashtëm, po vetëm njoftim i BQK-së.
- Ndryshimet në aktin e themelimit dhe statut, nuk kërkojnë miratim paraprak nga BQK, por vetëm njoftim.

Siguruesi, i cili ushtron veprimtari sigurimi në territorin e Republikës së Kosovës nëpërmjet degës së tij, në bazë të licencës së lëshuar nga BQK-ja, mund të shndërrojë degën e saj në një subjekt të varur, në formën e shoqërisë aksionare, me kërkesë të vet siguruesit ose me kërkesë të BQK-së.

Gjithashtu, BQK mund të kërkojë nga siguruesi i jashtëm, që është licencuar për të operuar në një ose më shumë degë në Kosovë, që ta shndërrojë degën në subjekt të varur të siguruesit të jashtëm nëse:

- ekziston ndonjë ndryshim material në pronësinë apo menaxhmentin e siguruesit të jashtëm për të cilën BQK-ja ka arsye të bazuara për shqetësim;
- ekziston rënie materiale në gjendjen financiare të siguruesit të jashtëm apo i nënshtrohet sanksioneve nga autoriteti mbikëqyrës përgjegjës i vendit amë, për shkelje materiale të ligjit ose praktikave të pasigurta dhe të pamatura;
- konsideron se operacionet e degës së siguruesit të jashtëm në Kosovë, mund të rrezikojnë stabilitetin financiar të sektorit të sigurimeve ose mund të jenë të dëmshme për interesin e policëmbajtësve;
- konsideron se mbikëqyrja nga autoriteti mbikëqyrës i vendit amë është joadekuate; dhe
- për arsye të menaxhimit të rrezikut.

Në rastin kur siguruesi kërkon që degën ta shndërrojë në subjekt të varur, siguruesi duhet ta marrë edhe pëlqimin me shkrim nga autoriteti mbikëqyrës i shtetit të tij. Pas aprovimit të shndërrimit dhe lëshimit të licencës së re, të gjitha të drejtat dhe obligimet e degës së siguruesit të jashtëm, i kalojnë subjektit të varur pasardhës.